



Sahare Reçica

**MBËSHTETJA E QENDRAVE
BURIMORE PËR NXËNËSIT
ME NEVOJA TË VEÇANTA
ARSIMORE TË PËRFSHIRË
NË SHKOLLA TË RREGULLTA**

Raport hulumtimi

Prishtinë, 2013

**MBËSHTETJA E QENDRAVE BURIMORE PËR
NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE
TË PËRFSHIRË NË SHKOLLA TË RREGULLTA**

Raport hulumtimi

Prishtinë, 2013

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autor

Sahare Reçica

Kryeredaktor

Nezir Çoçaj

Ekipi hulumtues

Sahare Reçica

Skender Mekolli

**Përpunimi i të dhënave dhe
përgatitja teknike**

Skender Mekolli

Lektor

Syhejl Havolli

Përmbajtja

Parathënie	5
1. Hyrje.....	9
1.1. Qëllimi i hulumtimit.....	13
1.2. Pyetjet kërkimore	13
1.3. Objektivat e hulumtimit	13
1.4. Përkufizimi i termave kyç	14
1.5. Rëndësia e hulumtimit	16
2. Metodologjia e hulumtimit.....	17
2.1. Ecuria e realizimit të projektit	17
2.2. Metodatat e hulumtimit.....	19
2.3. Instrumentet e hulumtimit.....	20
2.4. Popullacioni dhe mostra.....	22
3. Rezultatet e hulumtimit dhe interpretimi tyre.....	23
3.1. Funkzioni i Qendrave Burimore.....	23
3.1.1. Rezultatet e hulumtimit me drejtorët e Qendrave Burimore	26
3.1.2. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës udhëtues.	30
3.2. Përgatitja e shkollave të rregullta - përfshirëse për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore	36
3.2.1. Rezultatet e hulumtimit me drejtorët e shkollave të rregullta - përfshirëse	36
3.2.2. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës përfshirës	40

3.2.3. Rezultatet e hulumtimit me prindërit e nxënësve të përfshirë.....	51
3.3. Rezultatet e nxënësve të përfshirë	55
3.3.1. Rezultatet e arritshmërisë së nxënësve të përfshirë... 55	
3.3.2. Rezultatet e socializimit të nxënësit të përfshirë	58
3.4. Identifikimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve të pjesëmarrësve në hulumtim për fuqizimin e mbështetjes së nxënësve të përfshirë	60
3.5. Vëzhgimi në orët mësimore	64
4. Përfundime.....	67
5. Rekomandime	70
5.1. Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:	71
5.2. Zyrave të inspektimit:.....	72
5.3. Drejtorive komunale të Arsimit:.....	73
5.4. Drejtorëve të qendrave burimore:.....	74
5.4.1. Mësimdhënësve udhëtues:	74
5.5. Drejtorëve të shkollave përfshirëse:	75
5.5.1. Mësimdhënësve përfshirës:	76
5.5.2. Prindërve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore:	77
5.6. Fakultetit të Edukimit:.....	78
5.7. OJQ-ve:	78
Referencat:.....	79
Shtojcë: Lista e shkollave të përfshira në hulumtim.....	81

Parathënie

„Arsim për të gjithë” është një lëvizje shpresëdhënëse ndërkombëtare për të krijuar mundësitë e arsimimit për të gjithë personat, pa dallim. Parimi kryesor i Arsimit për të Gjithë është që të gjithë personat të kenë të drejtën në arsim, e cila e drejtë është potencuar që në Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, Konventën e OKB-së për të Drejta të Fëmijës (1989), Deklaratën e Salamankës të UNESCO-s (1994), Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2007), etj.

Në shekullin e kaluar kanë ekzistuar mendime të ndryshme për gjithëpërfshirjen e që disa vazhdojnë t’i mbrojnë edhe sot. Duke e mbrojtur qëndrimin për shkollat speciale, shprehen se „fëmijët mund të vendosen në arsim të përgjithshëm vetëm nëse kanë nevojë për mbështetje minimale”¹; se praktika e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta mund t’i dëmtojë të arriturat për nxënësit e tjerë, mbase sipas tyre, „aplikimi i dy e më shumë metodave nuk është e mundshme në klasë”. Por “hulumtimet e bëra me studentët pa nevoja të veçanta në shkollat e mesme dhe të larta, tregojnë se ata ndjehen më pak të frikësuar nga njerëzit që duken ndryshe apo kanë sjellje

¹ <http://www.european-agency.org/publications/ereports/key-principles-for-promoting-quality-in-inclusive-education-1/Key-Principles-2011-EN.pdf/view>, raport hulumtimi, shkarkuar në shtator 2012

ndryshe, sepse ata kanë ndërvepruar dhe tanimë, kanë përvoja. Të njëjtën gjë e kanë pohuar edhe prindërit e tyre. Në klasa përfshirëse nuk ka nxënës të lënduar”².

Nga ana tjetër, “studimet e bëra në vende të ndryshme të botës kanë treguar se shumë fëmijë të izoluar në shkolla speciale, nuk kanë arritur rezultate të mjaftueshme, kanë ngecë apo edhe kanë rënë nën nivelin hyrës”³, si pasojë e ndikimit të rrethit.

Kjo ka shtyrë përkrahësit e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara të mendojnë për një sistem tjetër të arsimit, që të gjithë të kenë mundësinë të arsimohen së bashku - konceptin e Arsimit Gjithëpërfshirës. Këto koncepte janë zhvilluar më tepër gjatë kësaj dekade së bashku me ndryshimin e bindjeve të tjera sociale dhe politike, ku ndarja apo izolimi i personave me aftësi të kufizuar, konsiderohet mohim i drejtësisë. Klasa gjithëpërfshirëse duhet të konsiderohet si vlerë, sepse nxënësit mësojnë nga njëri – tjetri, mësohen të jetojnë së bashku dhe njëherit fitojnë përvoja.

Sipas këtij koncepti, sistemi gjithëpërfshirës duhet të fokusojë *”fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ata të talentuar, fëmijët e rrugës dhe ata të cilët punojnë, fëmijët nga popullatat e viseve të largëta apo ato nomade, fëmijët nga minoritetet gjuhësore, etnike apo kulturore dhe fëmijët nga fushat apo grupet e tjera të pafavorizuara apo të marginalizuara”*⁴.

² <http://nvpie.org/inclusive.html>, shkarkuar në gusht, 2012

³ Po aty

⁴ Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, (pjesa e kornizës për veprim në arsimin me nevoja të veçanta), 2007, fq. 5

Ekziston një konsensus i gjerë ndërkombëtar se fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta arsimore dhe të të gjitha grupeve të tjera të marginalizuara duhet të përfshihen në mjediset arsimore të organizuara për shumicën e fëmijëve. Tashmë, shumica e vendeve ndërkombëtare e zhvillojnë sistemin e arsimit gjithëpërfshirës, por ballafaqohen me sfidat e zbatimit në praktikë të këtij procesi.

Edhe pse, sistemi i arsimit gjithëpërfshirës është përkrahur në politikat e shumicës së vendeve ndërkombëtare, shkollat speciale dhe klasat e bashkëngjitura vazhdojnë të funksionojnë në shumicën e shteteve të botës, por kryesisht për fëmijët me shkallë më të rëndë të ngecjes në zhvillim.

E drejta për arsimim është e garantuar për të gjithë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet e tjera në fuqi, sipas të cilave institucionet publike duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për secilin, në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre. Synimi i Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, ka nxitur ndryshime dhe reforma në sistemin e arsimit. Mbi parimin e gjithëpërfshirjes mbështeten edhe politikat arsimore në Kosovë.

Derisa “gjithëpërfshirja” është një koncept që përcakton filozofinë e organizimit të sistemit arsimor “për të gjithë”, “përfshirja” i referohet krijimit të mundësisë së çdo individi për qasje të barabartë dhe u mundëson të gjithëve arritje më të mëdha akademike dhe sociale. “Përfshirja mundëson që çdo nxënës në shkollë të ndjehet i mirëpritur, nevojat e tij dhe stilet e të nxënit

të vlerësohen”⁵. Sot përfshirja është pranuar gjerësisht, respekton të drejtat e të gjithëve dhe është qasja e preferuar e shekullit 21.

Arsimi gjithëpërfshirës – e drejtë për të gjithë, nuk mund të realizohet pa ofrimin e mundësisë përkatësisht mbështetjes së nevojshme institucionale. Por, kur flitet për mbështetjen në arsimin gjithëpërfshirës, kryesisht mendimet fokusohen tek fëmijët me aftësi të kufizuara si kategori më e ndjeshme e shoqërisë, andaj edhe përdorimi i kësaj terminologjie është çështje e cila po diskutohet nga ekspertë ndërkombëtarë të kësaj fushe.

⁵ <http://nvpie.org/inclusive.html>, raport hulumtimi, shkarkuar në shtator 2012

1. Hyrje

Bazuar në dokumentet e miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, vendi ynë synon një sistem arsimor gjithëpërfshirës ku *e drejta në arsim është e drejtë e të gjithëve* pa dalim nga gjendja e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, shqisore, gjuhësore apo ndonjë gjendje tjetër.

Dhënia e të drejtës për mundësi qasjeje në shkollë nuk nënkupton vetëm të drejtën për pjesëmarrje, por lidhet ngushtë edhe me ofrimin e shërbimeve mbështetëse të nevojshme për zhvillimin maksimal të potencialeve të të gjithë fëmijëve. Këto shërbime në shumicën e vendeve janë përgjegjësi të shpërndara në formë të hierarkisë dhe funksionojnë si një sistem për mbështetje, duke filluar nga politikat shtetërore e deri tek mësimdhënësi në klasë. Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nënkupton tërësinë e përkrahjes dhe ndihmës së organizuar ndërinstitucionale, në shërbim të fëmijëve me nevoja të veçanta për zhvillimin e potencialeve të tyre arsimore. Koncepti i përfshirjes ndërlidhet me ofrimin e mundësive për qasje të barabartë, bazuar në nevojat individuale.

Në vitet e para të pasluftës, qasja për personat me aftësi të kufizuara në jetën publike, ka qenë ndër prioritetet qeveritare dhe janë bërë më shumë lëvizje pozitive krahasuar me gjendjen e tanishme.

Aktualisht, arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë zhvillohet në sistem shumëkahësh: në shkolla speciale - qendra burimore, klasa të bashkëngjitura-dhoma të burimeve dhe në shkolla të rregullta - "gjithëpërfshirëse". Politikat arsimore të MASHT potencojnë respektimin e individualitetit dhe ngritjen e cilësisë në arsim, duke siguruar ofrim të mbështetjes së nevojshme që mundëson zhvillimin e potencialeve të nxënësve – e drejtë kjo, që u takon të gjithëve. Mirëpo, sistemi i mbështetjes është një sfidë në të gjitha vendet e botës të cilat zbatojnë sistem arsimor gjithëpërfshirës, e që varet kryesisht nga politikat vendore dhe zhvillimi ekonomik. Shumë vendeve që praktikojnë sistem arsimor gjithëpërfshirës, në sistemin e mbështetjes zbatojnë modelin e Qendrave Burimore.

Në sistemin e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, edhe Kosova ka filluar ta zbatojë modelin e Qendrave Burimore. Kështu që, shkollat speciale janë transformuar në qendra burimore dhe klasat e bashkëngjitura janë në proces të transformimit në dhoma të burimeve të cilat konsiderohen si resurse për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla apo klasa përfshirëse. Bazuar në këtë kontekst, disa shkolla të rregullta kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta arsimore, kanë punësuar „mësimdhënës gjithëpërfshirës” dhe nga MASHT emërtohen si „shkolla gjithëpërfshirëse”. Por shumë shkolla të rregullta të cilat kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta, janë në „listat” e mbështetjes së qendrave burimore.

Roli i qendrave burimore në sistemin e mbështetjes është që t’iu ofrojë mbështetje shkollave të rregullta të cilat përfshijnë nxënës

me nevoja të veçanta arsimore nëpërmjet bashkëpunimit dhe delegimit të mësimeve udhëtues. Ndërsa, shkollat e rregullta, sipas legjislacionit në fuqi janë të obliguara të përfshijnë të gjithë fëmijët e zonës që ato mbulojnë, pa dallim, përveç nëse organet kompetente në bazë të vlerësimit të tyre vendosin ndryshe.

MASHT mban përgjegjësitë e menaxhimit të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa drejtoritë komunale të arsimit ende nuk kanë marrë kompetencat e parapara dhe nuk kanë formuar ekipet vlerësuese, të cilat do të bënin vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta, do të identifikonin dhe përcaktonin nevojat për mbështetje, mangësi kjo e dukshme që reflekton në përcaktimin e standardeve për rezultate të pritura në arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Rreth zhvillimit të procesit të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta dhe mbështetjes së tyre nga qendrat burimore, kanë qarkulluar opinione të ndryshme.

Misioni i Institutit Pedagogjik të Kosovës është mbështetja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe institucioneve të tjera arsimore në Kosovë me rezultate të hulumtimeve të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e proceseve arsimore. Meqë mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta është një proces i ri në Kosovë, IPK është përcaktuar të realizojë këtë hulumtim, rezultatet e të cilit do të prezantojnë gjendjen dhe do të mundësojnë vlerësimin e saj me synim të nxjerrjes së rekomandimeve që do të adresohen tek

akterët relevantë për ndërhyrje të nevojshme në mbarëvajtjen e këtij procesi.

Hulumtimi do të trajtojë nivelin e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të cilët janë përfshirë në shkolla të rregullta dhe gjenden në listat e mësimdhënësve udhëtues të deklaruar se marrin mbështetje nga qendrat burimore, si dhe nivelin e përgatitjes së shkollave të rregullta – përfshirëse për ofrimin e mbështetjes së nevojshme në zhvillimin e potencialeve të tyre. Meqë nuk është bërë ndonjë vlerësim profesional paraprak në fillim të procesit të përfshirjes i cili do të mund të përcaktonte potencialet individuale të nxënësve të përfshirë, nuk mund të bëjmë një krahasim të rezultateve të tyre, por për këtë do të marrim opinionet e pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim. Ky hulumtim identifikon edhe vështirësitë që hasin akterët relevantë të këtij procesi.

Gjetjet në këtë hulumtim tregojnë se shërbimet e mbështetjes të ofruara nga qendrat burimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, nuk i plotësojnë nevojat e tyre në nivelin e kënaqshëm.

Fusha dhe fjalë kyçe

Fusha: Shërbimet e mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta.

Fjalë kyçe: mbështetje, nxënës, nevoja të veçanta arsimore, qendra burimore, shkolla të rregullta – përfshirëse, mësimdhënës udhëtues, mësimdhënës përfshirës, klasa përfshirëse, prindër.

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të pasqyrojë nivelin e mbështetjes së qendrave burimore për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta.

1.2. Pyetjet kërkimore

Për të realizuar qëllimin e hulumtimit, do të japim përgjigje në pyetjet:

- Çfarë është roli i qendrave burimore në procesin e përfshirjes dhe si po funksionojë ato?
- Çfarë është niveli i shërbimeve të mbështetjes nga mësimdhënësit udhëtues?
- Sa janë të përgatitura shkollat e rregullta - përfshirëse dhe mësimdhënësit për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore?
- Çfarë është performanca e nxënësve të përfshirë?
- Cilat janë vështirësitë e akterëve relevantë në zhvillimin e këtij procesi?

1.3. Objektivat e hulumtimit

Objektivat e përgjithshme

Objektivat e përgjithshme në këtë hulumtim janë:

-
1. Të identifikojë dhe pasqyrojë rolin e qendrave burimore në funksion të mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta;
 2. Të identifikojë dhe pasqyrojë përgatitjen e shkollave të rregullta për përfshirje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
 3. Të analizojë rezultatet, të nxjerrë përfundime dhe të rekomandojë për mbarëvajtjen e procesit të gjithëpërfshirjes.

Objektivat specifike të studimit:

1. Të identifikojë dhe pasqyrojë nivelin e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në klasa të rregullta nga mësimdhënësit udhëtues;

2. Të identifikojë dhe pasqyrojë përgatitjen e mësimdhënësve përfshirës për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në klasat e tyre;

3. Të pasqyrojë opinionet e respondentëve për rezultatet e nxënësve të përfshirë;

4. Të identifikojë vështirësitë në zhvillimin e procesit të përfshirjes.

1.4. Përkufizimi i termave kyç

Fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore - i referohet fëmijëve/nxënësve të cilët kanë vështirësi të theksuara në të nxënë krahasuar me bashkëmoshatarët dhe se, për zhvillimin e

potencialeve të tyre dhe arritjen e rezultateve të mundshme në arsim, kanë nevojë për mbështetje të veçantë.

Mbështetje - përkrahja dhe ndihma e organizuar institucionale, në shërbim të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore për zhvillimin e potencialeve të tyre.

Qendra burimore - është institucion arsimor, e transformuar nga shkolla speciale dhe e strukturuar në dy njësi: njësia e shkollës speciale që organizon mësimdhënien për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, dedikuar për llojet e ndryshme të dëmtimeve dhe njësia e shërbimeve të mbështetjes e cila mbështet shkollat e rregullta që përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Mësimdhënësi udhëtues - është mësimdhënës i punësuar në qendrën burimore, i cili mbështet mësimdhënësit përfshirës, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe prindërit e tyre në shkolla të rregullta.

Shkollë përfshirëse - është shkolla e rregullt e cila pranon nxënësit me nevoja të veçanta së bashku me të tjerët, pa marrë parasysh dallimet që mund të kenë dhe bënë ndryshime në funksion të mbështetjes së tyre.

Mësimdhënësi përfshirës - është mësimdhënësi që brenda klasës ka përfshirë edhe nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe përshtatë mësimdhënien mundësive dhe nevojave të tyre.

1.5. Rëndësia e hulumtimit

Projekti hulumtues është në harmoni me Planin Strategjik Arsimor të Kosovës (PSAK, 2011-2016) dhe dokumentet e tjera të miratuara nga MASHT i cili mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe plotësimin e kriterëve të cilët garantojnë cilësi në arsim.

Ndër faktorët nga të cilët varet cilësia në arsim dhe zhvillimi i potencialeve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është ofrimi i shërbimeve të mbështetjes, varësisht nga nevojat individuale të nxënësit. Hapat e parë të procesit të gjithëpërfshirjes, pjesërisht kanë filluar të zbatohen në praktikë, ndërsa në sistemin e mbështetjes, MASHT ka përzgjedhur modelin e qendrave burimore, andaj ky hulumtim do të ndikojë për të kuptuar nivelin e mbështetjes që u ofrohet fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla apo klasa të rregullta, për zhvillimin e potencialeve të tyre dhe rolin e qendrave burimore në këtë sistem.

Hulumtimi do të pasqyrojë edhe përgatitjen e shkollave të rregullta - përfshirëse për sigurimin e mbështetjes së fëmijëve të përfshirë, me që janë edhe faktorë kyç në këtë sistem.

Deri më tani, nuk ka të dhëna se është bërë ndonjë hulumtim tjetër i këtij lloji në Kosovë. Prandaj, ky hulumtim ka rëndësi të veçantë pasi që gjetjet e tij do të pasqyrojnë përmbushjen e obligimeve të përcaktuara nga politikat arsimore të MASHT-it për faktorët relevantë në sistemin e mbështetjes. Po ashtu, hulumtimi do të identifikojë edhe vështirësitë në mbarëvajtjen e këtij procesi.

Rekomandimet që do ta shoqërojnë këtë hulumtim, të adresuara për akterët e ndërlidhur në këtë proces, mund të shërbejnë si shtytje për ndërhyrje dhe përmirësimin e gjendjes.

2. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi u projektua si një studim cilësor dhe sasior i ndërlidhur në mënyrë reciproke në faza të ndryshme të realizimit të tij.

Në këtë kapitull do të trajtohet mënyra e realizimit të projektit, fazat e zhvillimit të tij, metodat dhe instrumentet e përdorura për hulumtim dhe përzgjedhja e popullacionit dhe mostrës.

Hulumtimi është realizuar në objektet e qendrave burimore dhe të disa shkollave përfshirëse, përkatësisht zyrat e drejtorëve dhe mësonjëtoret.

2.1. Ecuria e realizimit të projektit

Duke u bazuar në informata se sistemi i mbështetjes është sfidë për të gjitha vendet që aplikojnë sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe se po bëhen hulumtime të ndryshme në këtë fushë, lindi ideja për hulumtimin e ofrimit të mbështetjes në Kosovë, meqë nuk kemi të dhëna se është hulumtuar deri më tani ky problem. Por, për fokusimin e mbështetjes së qendrave burimore, jemi përcaktuar pas konsultimit të zyrtarëve të Njësisë për Arsim Special në MASHT, të cilët kishin rezerva rreth funksionimit të tyre.

Projekti është hartuar gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2012, ndërsa instrumentet e hulumtimit janë përgatitur gjatë muajit mars. Në muajin prill, instrumentet janë pilotuar në një shkollë, ndërsa në muajin maj dhe qershor, hulumtimi është realizuar në terren.

Fillimisht, përmes telefonit kemi kontaktuar me drejtorët e qendrave burimore dhe i kemi informuar për hulumtimin dhe qëllimin e tij, kemi caktuar oraret për intervista dhe kontaktet me mësimdhënësit udhëtues. Pastaj, kemi realizuar takimet me drejtorët dhe kemi kryer intervistat bazuar në pyetëtorin e përgatitur, duke përdorur edhe diktafonin. Ndërkohë kemi realizuar edhe takimet me mësimdhënësit udhëtues (me 5 nga gjithsej 8 mësimdhënës). Nga mësimdhënësit udhëtues kemi marrë informatat për punën e tyre dhe po ashtu listat e nxënësve dhe shkollave që ata i mbështesin. Kemi shkëmbyer e-mail adresat me qëllim të shkëmbimit të informatave, u janë dhënë pyetëtorët për t'u plotësuar në një afat prej 4-5 ditësh dhe janë kthyer përmes postës elektronike.

Bazuar në listat e mësimdhënësve udhëtues, në formë lotarie janë përzgjedhur shkollat, mësimdhënësit përfshirës, nxënësit dhe prindërit për realizimin e hulumtimit duke u bazuar në kriterin e shkollave qytet-fshat, me qëllim të krahasimit të gjendjes.

Me anë të telefonit janë kontaktuar drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit përfshirës, janë njoftuar për qëllimin e hulumtimit dhe janë caktuar oraret për takime. Me drejtorët e shkollave janë zhvilluar intervistat ndërsa mësimdhënësve iu janë shpërndarë pyetëtorët. Nga lista e shkollave të përzgjedhura, në fillim është përcaktuar vëzhgimi në nga një klasë përfshirëse, por gjatë vizitës

në shkolla me më shumë klasa përfshirëse, me kërkesën e mësimdhënësve përfshirës kemi bërë vëzhgim në dy, tri apo më shumë klasa brenda një shkolle. Njëkohësisht në klasa janë bërë edhe fotografi. Po ashtu edhe pyetësorët për prindër janë shpërndarë në të njëjtën ditë dhe është caktuar afati për plotësimin e tyre (afati prej 4 - 6 ditë). Më pas është bërë grumbullimi i pyetësorëve nga terreni dhe kodimi i tyre.

Nxjerrja e të dhënave nga pyetësorët është bërë gjatë muajit gusht - nëntor, fillimisht në programin Excel e më pas janë bartur në programin ESSP dhe janë përpunuar. Gjatë përpunimit të të dhënave kemi bërë pastrimin e pyetjeve në të cilat nuk kemi marrë përgjigje të sakta ose kemi konsideruar të panevojshme për hulumtim.

Po ashtu, duhet cekur se të dhënat e pjesëmarrësve në hulumtim, në raport janë prezantuar të grumbulluara në bazë të objektivave të kapitujve të caktuar.

Gjatë realizimit të projektit, kemi hasur në gatishmërinë e pakursyer të drejtorëve të qendrave burimore, mësimdhënësve udhëtues, disa drejtorëve të shkollave përfshirëse, mësimdhënësve përfshirës dhe të prindërve, gjë që e bëri më të lehtë dhe më cilësore punën hulumtuese në terren. Ndërsa sfidë në realizimin e këtij hulumtimi ishte anashkalimi i takimeve nga disa drejtorë të shkollave përfshirëse.

2.2. Metodatat e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit janë zbatuar disa metoda:

- Metoda e analizës teorike: janë analizuar dokumentet, si: ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë,

vendimet etj., të miratuara nga MASHT si dhe gjetjet e hulumtimit;

- Metoda e intervistës: janë intervistuar drejtorët e qendrave burimore dhe të shkollave përfshirëse;
- Metoda e anketës: janë anketuar mësimdhënësit udhëtues, mësimdhënësit përfshirës dhe prindërit e nxënësve të përfshirë;
- Metoda e vëzhgimit: është bërë vëzhgimi në orët mësimore të klasave përfshirëse;
- Metoda statistikore: Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në programin SPSS dhe janë paraqitur në mënyrë grafike;
- Metoda e krahasimit: gjetjet në hulumtim janë krahasuar me qëllim të nxjerrjes së vlerësimit dhe përfundimit.

2.3. Instrumentet e hulumtimit

Për marrjen e sa më shumë informatave dhe grumbullimin e sa më shumë të dhënave, në mënyrë që hulumtimi të jetë më i besueshëm, janë hartuar instrumente për të gjitha grupet – akterët e rëndësishëm që ndërlidhen në këtë sistem.

Instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim janë:

- Pyetësorët për intervistë të drejtorëve të qendrave burimore;

-
- Pyetësorët për intervistë të drejtorëve të shkollave përfshirëse;
 - Pyetësorët për mësimdhënës udhëtues;
 - Pyetësorët për mësimdhënës përfshirës;
 - Pyetësorët për prindër të nxënësve të përfshirë;
 - Lista e vëzhgimit në orët mësimore.

Pyetësorët e përgatitur për intervistë të drejtorëve të Qendrave Burimore në Kosovë dhe drejtorëve të shkollave përfshirëse, kishin për qëllim mbledhjen e të dhënave për rolin e tyre në organizimin dhe menaxhimin e shërbimeve të mbështetjes së nxënësve me nevoja të veçanta të përfshirë në klasa të rregullta. Intervistat janë incizuar në diktafon, por kohë pas kohe kishte disa pengesa teknike, andaj pas intervistimit, janë plotësuar me shkrim.

Janë hartuar tri lloj pyetësorësh: pyetësori për mësimdhënësin përfshirës, për mësimdhënësin udhëtues dhe pyetësori për prindërit e nxënësve të përfshirë. Qëllimi i pyetësorëve ka qenë mbledhja e informatave për nivelin e përgatitjes së mësimdhënësve përfshirës, mësimdhënësve udhëtues dhe prindërve të nxënësve të përfshirë, bashkëpunimi, funksionimi i shërbimeve të mbështetjes për zhvillimin e potencialeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, vlerësimi i tyre për rezultatet e nxënësve të përfshirë dhe vështirësitë e hasura në këtë proces.

Lista e vëzhgimit është plotësuar gjatë vëzhgimit të drejtpërdrejt në orët mësimore në klasat më nxënës të përfshirë në shkolla të

rregullta, duke u fokusuar në akomodimin, përshtatshmërinë e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta në klasë dhe performancën e tyre.

2.4. Popullacioni dhe mostra

Për një rezultat sa më të besueshëm, për hulumtim janë përzgjedhur 5 nga gjithsej 7 qendrat burimore që funksionojnë në Kosovë.

Mostra e hulumtimit është përcaktuar duke u bazuar në përvojën për arsim special të pesë qendrave burimore (në Pejë - dëmtime në të parë, Prishtinë - dëmtime intelektuale, Prizren - dy qendrat: dëmtime intelektuale dhe dëmtime në të dëgjuar dhe Mitrovicë - dëmtime intelektuale), ku nga ato kanë qenë të fokusuar mësimdhënësit udhëtues dhe drejtorët e shkollave. Nga listat e shkollave që i mbështesin mësimdhënësit udhëtues kemi përcaktuar mostrën: nga 2-3 shkolla për secilin duke iu referuar një zone urbane dhe një rurale. Ndërsa për vëzhgim jemi përcaktuar nga një klasë në çdo shkollë, por numri i vëzhgimeve është rritur me kërkesën e disa mësimdhënësve përfshirës të cilët nuk ishin në listën e të përzgjedhurve.

Për të marrë informacione sa më të plota dhe një pasqyrë sa më të saktë të gjendjes, për këtë hulumtim janë përzgjedhur:

- 5 drejtorë të qendrave burimore;
- 5 mësimdhënës udhëtues;
- 12 drejtorë të shkollave përfshirëse;

-
- 32 mësimdhënës përfshirës;
 - 32 prindër të nxënësve të përfshirë.

Pyetëtorët i kanë plotësuar 32 mësimdhënës përfshirës dhe 26 prindër të nxënësve të përfshirë. 6 prindër nuk iu kanë përgjigj kërkesës sonë për plotësimin e pyetëtorit. Ndërsa, vëzhgimi është kryer në 19 klasë për 19 nxënës të përfshirë, nga gjithsej 12, sa ishin të planifikuar. Rritja e numrit të vëzhgimeve të realizuara është bërë me kërkesën e vet mësimdhënësve të tjerë përfshirës brenda shkollës, të cilët nuk ishin në listë por shprehnin nevojat e tyre për vizitë në klasë, këshilla dhe konsultime. Në disa raste brenda klasës kishte më shumë se një nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe vëzhgimi është bërë në grup.

3. Rezultatet e hulumtimit dhe interpretimi tyre

Gjetjet nga pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim, janë paraqitur të sistemuara në kapituj duke u bazuar në objektiva dhe pyetjet kërkimore të studimit, edhe pse të gjitha janë të ndërlidhura mes vete.

3.1. Funkzioni i Qendrave Burimore

Për zbatimin e parimit të gjithëpërfshirjes dhe arritjes së sigurimit të cilësisë në arsim, është i domosdoshëm siguri i shërbimeve për mbështetje të nevojshme individuale. Për realizimin e shërbimeve të mbështetjes, ndër të tjera, MASHT ka përzgjedh modelin e Qendrave Burimore – të transformuara nga shkollat

speciale, model ky i zbatuar në shumë vende të botës, si: të gjitha vendet anëtare të BE, SHBA, Japoni etj., roli i qendrave burimore është (përveç arsimimit të fëmijëve brenda qendrës) që të mbështesë shkollat e rregullta, të cilat përfshijnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Për të njohur më konkretisht funksionin e qendrave burimore në procesin e gjithëpërfshirjes, nga drejtorët e këtyre qendrave kemi marrë dokument-vendimet të lëshuara nga MASHT, në të cilat shkruan:

„Bazuar në nenin 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe të nenin 4 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) më 20/10/ 2010, nxjerr vendim për transformimin e të gjitha shkollave speciale në qendra burimore, me ç’rast qendrat burimore ristrukturohen në dy njësi:

1. *Njësia e shkollës speciale* për fëmijët me dëmtime (varësisht nga shkolla): në të parë, në të dëgjuar apo intelektuale të rënda dhe të shumëfishta, dhe
2. *Njësia e shërbimeve të mbështetjes* e cila do të ofrojë mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimtarëve, edukatorëve dhe prindërve të tyre në shkolla të rregullta”⁶.

⁶ Dokumentet janë marrë nga drejtorët e qendrave burimore gjatë fazës së realizimit të hulumtimit në terren.

Po ashtu me një vendim nga MASHT janë themeluar *ekipet bërthamë* të cilat i përbëjnë: drejtorët e qendrave, mësimitdhënësit udhëtues, mësimitdhënës tjerë të shkollës, detyrë e të cilëve është koordinimi i shërbimeve të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta dhe mësimitdhënësit e tyre.

Brenda njësisë së shërbimit të mbështetjes janë të formuara edhe *ekipet për shërbimet e mbështetjes* të cilat kanë për detyrë të ofrojnë mbështetje për mësimitdhënës të rregullt, prindër dhe nxënës me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, si: trajnime, materiale, konsulta dhe ndihmë të drejtpërdrejtë në klasë.

Në Kosovë ekzistojnë 7 qendra burimore: Qendra Burimore për fëmijë me dëmtime në të parë në Pejë; Qendra Burimore për fëmijë me dëmtime në të dëgjuar në Prizren; Qendrat Burimore për fëmijë me dëmtime intelektuale në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe Shtime. Në veriun e Mitrovicës ekziston një Qendër Burimore ku vijojnë mësimin fëmijët serbë, por nuk është e integruar në sistemin arsimor të MASHT-it dhe nuk kemi pasur qasje në të.

Pjesë e stafit të qendrave burimore, e njëkohësisht edhe ekipeve mbështetëse janë edhe *mësimitdhënësit udhëtues*.

Bazuar në *kontratat e punës së mësimitdhënësve udhëtues* të lëshuara nga MASHT, detyrat e tyre janë:

- Të identifikojnë nxënësit me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta dhe institucione të tjera;

-
- Të bashkëpunojnë me shkolla të rregullta;
 - Të identifikojnë nevojat e nxënësve dhe mbështesin me materiale dhe mjete tjera të nevojshme;
 - Të mbështesin mësimdhënësit e shkollave të rregullta me këshilla profesionale;
 - Të koordinojnë punën e qendrës burimore me shkolla të rregullta;
 - Të bashkëpunojnë me ekipin profesional të shkollës.

Duke pasur parasysh detyrat e Qendrave Burimore, janë fokusuar edhe pyetjet e hulumtimit për drejtorët dhe mësimdhënësit udhëtues.

Bazuar në këto dokumente, ekipet për shërbimet e mbështetjes në qendrat burimore dhe mësimdhënësit udhëtues nuk i kanë detyrat e precizuara për ofrimin e shërbimeve.

3.1.1. Rezultatet e hulumtimit me drejtorët e Qendrave Burimore

Bazuar në vendimin për funksionimin e qendrave burimore, janë zhvilluar edhe intervistat gjysmë të strukturuar të orientuara në pyetësoin e përgatitur për drejtorët e qendrave burimore, i cili kishte për qëllim marrjen e informatave për nivelin e realizimit të detyrave rreth shërbimeve të mbështetjes së shkollave të rregullta të cilat kanë përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Gjetjet nga intervistat me drejtorë të Qendrave Burimore janë:

-
- Nga drejtorët janë deklaruar se me vendim të njëjtë të lëshuar nga MASHT, të gjitha shkollat speciale janë transformuar në qendra burimore.
 - Në pyetjen për funksionimin e ekipeve mbështetëse, të gjithë drejtorët janë deklaruar se janë pjesë e ekipit bërthamë të cilat përbëhen prej nga 3-5 anëtarë, ndërsa ekipet për shërbimet e mbështetjes përfshijnë shumicën nga mësimdhënësit e shkollës. Sipas tyre, ekipet e kryejnë funksionin e tyre në bazë të përcaktimit të detyrave. Këto ekipe bëjnë vlerësimin e fëmijëve për përfshirje, përgatisin materiale mësimore për mbështetje, konsultohen dhe japin këshilla dhe trajnime për mësimdhënësit përfshirës dhe prindër, identifikojnë fëmijë me nevoja të veçanta. 20% të drejtorëve janë deklaruar se „nuk janë të kënaqur me nivelin e realizimit të aktiviteteve nga këto ekipe, sepse nuk është paraparë stimulim shtesë për punën ekstra që e kryejnë krahasuar me kolegët e tjerë, ndërsa 20% shprehen se „duhet bërë punën e pastaj të kërkohet pagesa”, gjë që na bënë të kuptojmë se këto ekipe nuk janë shumë aktive. Të tjerët nuk e kanë potencuar këtë problem. Edhe mësimdhënësit udhëtues në sugjerimet e tyre kanë kërkuar aktivizim më të madh të këtyre ekipeve.
 - Në pyetjen për mbështetjen që ofrojnë mësimdhënësit udhëtues, drejtorët janë deklaruar se ata bëjnë planifikimin në bazë të nevojave të nxënësve të përfshirë dhe dorëzojnë raportet e punës në terren, por 40% e drejtorëve deklarohen se puna e tyre „nuk është të qëndrojnë gjatë në qendër por pranë nxënësve në shkolla të rregullta-përfshirëse”, dhe se

realizimin e punës në terren e shohin si të dyshimtë pasi që ata nuk i monitoron askush dhe se nuk dihet sa e realizojnë atë. 20% e drejtorëve janë deklaruar se mangësinë e shohin tek mosnjohja e gjuhës së shenjave dhe mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave dhe mungesa e automjetit për dalje në terren. 20% e drejtorëve kanë potencuar faktin se mësimdhënësit e shkollës të cilët kanë përvojë pune me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, e që sipas tyre do të ishin më të suksesshëm në terren, nuk pranojnë të jenë mësimdhënës udhëtues pasi që terreni është më i lodhshëm, ndërsa nuk ka asnjë stimulim shtesë.

- Drejtorët deklarohen se kontaktojnë me drejtorë të shkollave të rregullta, sidomos gjatë procesit të transferimit të nxënësve dhe pohojnë se e monitorojnë zhvillimin e procesit të përfshirjes.
- Sipas tyre, një numër i nxënësve të përfshirë janë përshtatur shumë mirë dhe kanë arritur rezultate shumë të mira si rezultat i vullnetit për punë të mësimdhënësve përfshirës.
- Por, ata deklarohen se, shpesh herë hasin në vështirësi pasi që ndodh që nxënësit të kthehen përsëri në Qendër Burimore si rezultat i mosfunksionimit të procesit apo lëvizjes së nxënësve nga klasa në klasë brenda shkollës përfshirëse e që reflekton pasoja tek nxënësit. Këtë mosgatishmëri të mësimdhënësve ata e shohin si rezultat të mosstimulimit në pagë për rastet e përfshirjes apo edhe të numrit të madh të nxënësve brenda klasës.

-
- Po ashtu, ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore edhe nga shkollat e rregullta që marrin mësim plotësues në qendër burimore, me kërkesën e mësimdhënësit apo edhe iniciativën e prindit.

Për numrin e nxënësve dhe shkollave që mbështeten nga qendra burimore, të gjithë drejtorët deklarorin se këtë më së miri e dinë mësimdhënësit udhëtues, sepse ata i kanë të evidentuar në lista.

Nga të dhënat e grumbulluara del se: tri qendra burimore kanë nga 2 mësimdhënës udhëtues, ndërsa 2 të tjerat, vetëm nga 1 e tërë Kosova mbulohet me 5 mësimdhënës udhëtues për fëmijët me dëmtime intelektuale të cilët janë të ndarë në regjione sipas qendrave burimore ku ato veprojnë. 2 mësimdhënës udhëtues për persona me dëmtime në të parë dhe 1 mësimdhënës udhëtues për fëmijë me dëmtime në dëgjim, e „mbulojnë” tërë Kosovën.

- Drejtorët janë deklaruar se janë shumë pak mësimdhënës udhëtues krahasuar me nevojat për mbështetje në terren dhe po ashtu shkollat e shpërndara dhe mbulimi i hapësirës së gjerë gjeografike është vështirësi që e bënë të pamundur realizimin me sukses të detyrave të tyre.
- Të gjithë drejtorët kanë shprehur nevojën e nxjerrjes së një udhëzimi administrativ i cili do të rregullonte funksionimin e qendrave burimore, do t'i përcaktonte detyrat e ekipeve bërthamë dhe ekipeve për shërbimet e mbështetjes.

3.1.2. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës udhëtues

Bazuar në kontratat e tyre të punës, janë adresuar edhe pyetjet në pyetësozin e përgatitur për mësimdhënës udhëtues. Informatat e rëndësishme për kryerjen e detyrave të tyre të punës kemi konsideruar se do t'i marrim përmes pyetjeve të adresuara dhe kemi të dhënat në vijim:


- Kualifikimi i mësimdhënësve udhëtues:

Realizimi me sukses i detyrave të mësimdhënësve udhëtues kërkon përgatitje të lartë profesionale. Bazuar në këtë kontekst, në pyetësozin e përgatitur për mësimdhënës udhëtues është parashtruar pyetja për nivelin arsimor të përgatitjes së tyre.

- Nga gjetjet, rezulton se *struktura kualifikuese* e mësimdhënësve udhëtues është e lartë. Nga 5 të anketuarit, titullin Master e kanë 3 apo 60%, kurse me fakultet janë 2 apo 40% prej tyre (në drejtime adekuate). Mirëpo, nga këta mësimdhënës udhëtues, 2 prej tyre kanë përvojë pune si mësimdhënës në qendrat burimore përkatëse, ndërsa 3 të tjerët janë punësuar drejtpërdrejt si mësimdhënës udhëtues - pa ndonjë përvojë paraprake me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.


- Për *zhvillim profesional* është e rëndësishme edhe ndjekja e trajnimeve adekuate për specifikat e punës. Trajnimet e vijuar nga mësuesit udhëtues janë: Programi për Zhvillim Profesional (FSDEK) të cilin e kanë ndjekur 60% prej tyre, teknikat e Mësimdhënies Aktive (Grupi TEMA) 20%, Mësimdhënia me Nxënësin në Qendër 20%. Këta mësimdhënës kanë ndjekur edhe trajnime të tjera, por në përqindje të vogël, siç janë Autizmi dhe

metodat e punës, Trajnimi për PIA-n, menaxhimi i konflikteve, Strategjitë e të mësuarit, Format dhe metodat e reja mësimore, ICT and E- Learning, Syndrome Down etj.



Grafiku nr. 1. Trajnimet e ndjekura nga mësimsdhënësit udhëtues

Sipas mësimsdhënëseve udhëtues *numri i nxënësve* të cilët ata i mbështesin sillet prej 5 – 30 nxënës. Tre nga të anketuarit kanë deklaruar se ata mbështesin 26-30 nxënës, dy të tjerët 5-10, përkatësisht 11-15 nxënës.




Grafiku nr. 2. Numri i nxënësve që mbështesin mësimsdhënësit udhëtues

- Në pyetjen se *sa nxënës të identifikuar nga ju kanë nevojë për mbështetje*, 40% e mësimsdhënëseve deklarojnë se për këtë

mbështetje kanë nevojë 10-20 nxënës, kurse 20% shprehen për nevojën e mbështetjes së 21-30 nxënësve, gjë të cilën ata nuk mund ta mbulojnë. Dy nga ta nuk janë përgjigjur fare. Nxënësit që mbështeten nga mësuesi udhëtues janë të shpërndarë në shumë shkolla. 60% e *mësimdhënësve udhëtues* janë përgjigjur se nxënësit të cilët i mbështetin ata, janë të shpërndarë në 16-20 shkolla, kurse 40% nga ta, mbështetin nxënësit e 5-10 shkollave. Ata kanë deklaruar se numri i shkollave nuk paraqet ndonjë problem aq të madh, por vështirësi paraqet hapësira gjeografike e shtrirjes së shkollave që mbulojnë: regjionet e caktuara apo tërë territori i Kosovës, kurse mundësitë për mbështetje në nivelin e duhur, janë të kufizuara.


- Në pyetjen për *vlerësimin e nxënësve për marrjen e vendimit për mbështetje apo përfshirje* nga qendra burimore në shkollë të rregullt, sipas 40% të mësimdhënësve, e bëjnë mësuesi, prindi dhe QB. Po kaq deklarohen se vlerësimin e bënë Grupi vlerësues i QB dhe mësuesi udhëtues, 20% mendojnë se këtë e bënë mësuesi udhëtues e po kaq shprehen edhe për vlerësimin e bërë nga mësuesi udhëtues dhe ai i rregullt.



Grafiku nr. 3. Kush e bënë vlerësimin për mbështetje dhe merr vendim për përfshirje

- Për ofrimin e mbështetjes për nxënësin e caktuar të gjithë mësuesit udhëtues (100%) kanë deklaruar se konsultohen me prindin. Përveç se me prindin ata shprehen se konsultohen edhe me ekipin bërthamë, mësuesit e qendrës burimore dhe mësuesin e shkollës/klasës përfshirë në shkallën 80%. Po ashtu ata konsultohen edhe me ekspertë të fushave përkatëse dhe shërbimin profesional të shkollës (pedagog, psikolog, mjek, punëtor social, tifolog, etj.)


- Çfarë shërbime mbështetëse iu ofroni mësuesve që kanë përfshirë në klasë të tyre fëmijë me NVA? Të gjithë mësuesit e anketuar kanë theksuar se ata iu ndihmojnë mësuesve përfshirës të cilët në klasat e tyre kanë FNV në: përshtatjen e kurrikulës – hartimin e PIA-s. Po ashtu, edhe në përshtatjen e materialit mësimor, të gjithë mësuesit udhëtues janë deklaruar se ofrojnë këtë ndihmë. Në metodologji të mësimit, ndihmën e tyre e ofrojnë 80% të mësuesve, kurse asistencë në klasë, 20%. Forma të tjera të ndihmës që ofrojnë mësuesit udhëtues për mësuesit përfshirës janë: trajnime dhe kurse për nxënësit e shkollës së rregullt (rreth 60%).



Grafiku nr. 4. Mbështetja që ofrojnë mësuesit udhëtues

- *A mendoni se nxënësit kanë nevojë për më shumë mbështetje?*
 Në këtë pyetje mësimitdhënësit udhëtues kanë pasur mundësi të japin më shumë se një përgjigje.

Nga përgjigjet e të gjithë të anketuarve, rezulton se nxënësit e përfshirë kanë nevojë për mbështetje më të madhe. Kjo mbështetje sipas 40% të mësimitdhënësve konsiston në mbështetje në orë mësimore së paku dy herë në javë; në material mësimor (20%); në trajnime (20%); përgatitje për klasat më të larta ku ka nevojë për mbështetje (20%); vijimi i kurseve të shkurtra në QB (20%); dhe mbështetja nga prindi (20%). Grafiku në vazhdim paraqet nevojat për më shumë mbështetje.




Grafiku nr. 5. Nevojat për më shumë mbështetje

- *Për orarin e takimeve në shkollë përfshirëse*, mësimitdhënësit udhëtues janë deklaruar se nuk kanë ndonjë orar të caktuar por këtë e bëjnë sipas nevojës.

- Në pyetjen *se funksionon apo jo rrjeti i mësimitdhënësve udhëtues*, 80% nga të anketuarit janë përgjigjur me “po”, kurse 20% nuk kanë dhënë përgjigje.

Për qëllimin e bashkëpunimit në këtë rrjetë, 33% e tyre janë shprehur se është mbështetja e mësimeve, mbështetja e nxënësve, mbështetja e prindërve. Nuk janë përgjigjur 66.7%

- A keni hasur në vështirësi gjatë këtij procesi? Të gjithë të anketuarit i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetjeje. Ata kanë përmendur disa nga vështirësitë që kanë hasur gjatë këtij procesi. Jogatishmëria e mësuesit të pranojë fëmijë me nevoja të veçanta e po ashtu edhe refuzimi i shkollave për t'i pranuar ata, është ndër problemet më të mëdha. Edhe mos bashkëpunimi i shkollës, prindit dhe mësimeve, paraqet vështirësi të konsiderueshme.



Grafiku nr. 6. Vështirësitë në mbështetjen e nxënësve përfshirës

Mësimeve udhëtues, qasjen e tyre në shkolla të rregullta u mundëson një *dokument-kërkesë* e lëshuar nga MASHT, në bazë të së cilës obligohen drejtorët dhe mësimeve e shkollave t'iu ofrojnë qasje dhe bashkëpunim me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

3.2. Përgatitja e shkollave të rregullta - përfshirëse për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore

Deri më tani, shkollat e rregullta kanë funksionuar sipas sistemit tradicional të arsimit ku fëmijët me nevoja të veçanta arsimore nuk kanë pasur mundësi qasjeje, apo edhe nëse në raste të rralla kanë qenë pjesë e nxënësve të shkollës, nuk është bërë asgjë e veçantë për ta. Ata është dashur t'u përshtaten kushteve brenda shkollës. Tani, sipas politikave të reja arsimore të Kosovës, çdo shkollë është e detyruar të përfshijë të gjithë fëmijët pa dallim të zonës së caktuar që ajo mbulon, përveç nëse organet kompetente vendosin ndryshe. Për realizimin e këtij misioni, nevojitet edhe përgatitja dhe reformimi i përgjithshëm i shkollës që nënkupton përshtatjen e shkollës për të gjithë nxënësit duke respektuar individualitetin e secilit, përfshirë këtu edhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Reformimi i shkollës duhet të filloj nga drejtori, personeli brenda shkollës e deri tek mësimdhënësi në klasë si faktor kyç i procesit. Për të ditur gjendjen në shkollat e rregullta - përfshirëse, kemi kërkuar të dhëna nga drejtorët e shkollave, mësimdhënësit të cilët kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta në klasë dhe prindërit e nxënësve të përfshirë.

3.2.1. Rezultatet e hulumtimit me drejtorët e shkollave të rregullta - përfshirëse

Për drejtorë të shkollave të rregullta – përfshirëse, kemi përgatitur intervista gjysmë të strukturuar. Pyetjet kanë qenë të

orientuara në qëllimin e hulumtimit, me synim të marrjes së të dhënave më të sakta për përgatitjen e drejtorëve për procesin e përfshirjes dhe mbështetjen e shkollës në këtë proces. Intervistat e realizuara janë incizuar në diktafon dhe në raste të pengesave teknike, janë përshkruar menjëherë pas realizimit të tyre.

Por, edhe pse i kemi njoftuar 2-3 ditë më herët për qëllimin e hulumtimit dhe kemi caktuar orarin e takimeve, ne kemi takuar dhe zhvilluar intervistën vetëm me *6 drejtorë (50%) nga gjithsej 12 drejtorë të planifikuar*, sepse 6 (50%) nga ata, nuk ishin në vendin e tyre të punës në kohën e caktuar për takim. Disa nga ata kishin përcjellë porosinë tek zëvendësit e tyre ose ndonjë nga zyrtarët e personelit të shkollës që të na pritnin për takim. Por, zyrtarët e këtyre shkollave të cilët ne i takuam, përveç se ishin në dijeni që mësimdhënësi i caktuar ka fëmijë me nevoja të veçanta në klasë, nuk ishin në gjendje të na japin asnjë informatë tjetër. Ata na udhëzonin që për çdo gjë të informohemi nga mësimdhënësit përfshirës të cilët veç ishin të njoftuar për qëllimin e vizitës. Andaj, sipas opinioneve tona, ata drejtorë, përveç se kanë regjistruar fëmijë me nevoja të veçanta në shkollë – kanë kryer njërën ndër obligimet e tyre, nuk kanë gatishmëri dhe vullnet për mbështetje në zhvillimin e procesit, andaj edhe iu iknin deklarimeve. Po në ato shkolla, *edhe mësimdhënësit gjatë bisedave janë shprehur se nuk kanë asnjë mbështetje nga shkolla, përkundrazi, injorohen kërkesat e tyre për mbështetjen e nxënësve të përfshirë.*

- *Numri i nxënësve të përfshirë në shkollë: drejtorët e kontaktuar deklarojnë se në shkollat e tyre janë të përfshirë nga 2, 3 e deri në 7 nxënës me nevoja të veçanta arsimore.*

- *Përcaktimin e klasës dhe mësimdhënësit përfshirës, drejtorët deklarohen se e kanë bërë duke u bazuar në performancën e mësimdhënësit dhe përfshirjen në trajnimet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, ndërsa 16.6% deklarohen se „ka qenë fat i mësimdhënësit” pasi që shkolla ka vetëm një paralele dhe nuk ka mundësi zgjedhjeje. Të gjithë (100%) janë deklaruar se janë munduar të përzgjedhin mësonjëtoen më të mirë.*

- *Numri i madh i nxënësve në klasa është një problem me të cilin ballafaqohen shumë shkolla, e sidomos ato që përfshijnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Për zgjidhjen e këtij problemi, disa drejtorë nuk kanë ndërmarrë masa të nevojshme për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasa përfshirëse, ndërsa të tjerët i bëjnë përgjegjës drejtoritë komunale të arsimit se nuk iu kanë lejuar rritjen e numrit të mësimdhënësve. Nga ana tjetër, shkollat përfshirëse nuk kanë ndonjë udhëzim administrativ apo vendim të veçantë i cili do t'i përcaktonte kriteret për numrin e nxënësve në klasat përfshirëse.*

- *Drejtorët e shkollave përfshirëse janë deklaruar se e monitorojnë zhvillimin e procesit, bashkëpunojnë me mësimdhënësit, prindërit, i përfshijnë nxënësit me nevoja të veçanta në aktivitete që zhvillohen në shkollë, përzgjedhin mësimdhënësit më të përgatitur për punë me nxënës me nevoja të veçanta – kur kanë mundësi, bashkëpunojnë me qendra burimore, përzgjedhin mësonjëtoe më të përshtatshme, etj.*

- Po ashtu drejtorë janë deklaruar se kanë qenë të përfshirë në ndonjë trajnim për fëmijët me nevoja të veçanta, gjë që iu kanë ndihmuar për qasje ndaj nxënësve.

- Por të gjithë drejtorët deklarohen se iu mungon *shërbimi profesional* brenda shkollës (psikologu, pedagogu apo ndonjë ekspert për FNV).

Po ashtu deklarohen edhe për mungesë të mjeteve mësimore.

- Ndërsa për *bashkëpunim me qendrat burimore* ata deklarohen se kanë kontakte, vjen ndonjëherë mësimdhënësi udhëtues dhe i viziton, e këshillon mësimdhënësin përfshirës, por këtë nuk e konsiderojnë si ndonjë mbështetje të rëndësishme dhe cilësore.

- 16,6% të drejtorëve kanë cekur se në *planin e veprimit* kanë paraparë hapësirë për mësim shtesë për mësimdhënësin përfshirës dhe formimin e komisionit për vlerësimin e nevojave të nxënësve (për vitin vijues), 16.6 % kanë thënë se *do të planifikojnë* për vitin e ri shkollor, ndërsa 16% të drejtorëve kanë *përgatitur projekt (për donatorë)* për aspektin e gjithëpërfshirjes. Ndërsa, rreth 84% e të intervistuarve janë deklaruar se *nuk kanë ndonjë plan të veçantë për gjithëpërfshirje*.

- Po ashtu, të gjithë janë deklaruar se *fëmijët në shkollë janë regjistruar* kryesisht me iniciativën e prindërve por edhe një numër i tyre janë regjistruar në bazë të preferencës së qendrave burimore.

Opinionet tona për drejtorë e kontaktuar janë: 50% (3 drejtorë) nga të kontaktuarit me të cilët arritëm t'i realizojmë intervistat e

planifikuara, vërehej vetëdijesimi i tyre për konceptin e gjithëpërfshirjes, gatishmëria dhe interesimi i tyre për akomodimin e nxënësve brenda shkollës, ndërsa 50% e drejtorëve, përveç pranimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollë, nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet tjetër të veçantë për mbështetje.

Për deri sa Qendrat Burimore funksionojnë në bazë të vendimeve të cekura më lart, të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shkollat e rregullta – përfshirëse të cilat kanë përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore nuk kanë ndonjë dokument – vendim apo mbështetje financiare të veçantë i cili do t'i bënte të dalloheshin ato nga shkollat tjera dhe do t'i obligonte për ofrim të mbështetjes së nevojshme.


3.2.2. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënës përfshirës

Bazuar në faktin se mësimdhënësi në klasë (përfshirës) është faktori kyç i cili realizon përfshirjen, ne kemi përgatitur pyetësorë me pyetje që orientojnë hulumtimin e nivelit të përgatitjes së tyre për përfshirje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe shërbimet e ofruara nga qendrat burimore, përkatësisht mësimdhënësit udhëtues.

- *Përgatitja profesionale e mësimdhënësve përfshirës*: sipas gjetjeve në hulumtim, nga 32 mësimdhënës të anketuar, 14 apo 43.8% kanë të kryer fakultetin, me Shkollë të Lartë Pedagogjike janë 13 mësimdhënës apo 40.6%. Me Shkollë Normale janë 3 apo 9.4%, kurse me titullin Master janë 2 apo 6.2%,

- Por, meqë në të kaluarën arsimit i lartë nuk ka ofruar përgatitje profesionale për punë në aspektin e gjithëpërfshirjes, *zhvillimi profesional dhe pjesëmarrja në trajnime e mësimdhënësve përfshirës është e domosdoshme për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore*. Sa i përket vijimit të trajnimeve, shumica e mësimdhënësve janë përgjigjur se kanë kryer trajnime, por vetëm një pjesë e tyre kanë ndjekur trajnime që kanë të bëjnë me specifikat e punës me FNV. Në këtë pyetje, mësimdhënësit kishin mundësi të rrumbullakojnë më tepër se një përgjigje.


Trajnimi më i ndjekur sipas të anketuarve është Mësimdhënia me Nxënësin në Qendër (nga 69.2% të tyre). Pas tij vjen Mendimi kritik (MKLSH) me 61.5%, Teknikat e mësimdhënies Aktive (TEMA) me 34.6%, Monitorimi i mësimdhënësve në orë mësimore me 30.8 % dhe Programi për Zhvillim Profesional (FSDEK) me 26.9%.



Grafiku nr. 7. Pjesëmarrja e mësimdhënësve përfshirës në programet e trajnimit

Të gjitha trajnimet e “tjera” të ndjekura përfaqësohen me 46,2% ku bëjnë pjesë: Syndrome Down, Strategjitë e vetëvlerësimit, Mësimi i FNV, Edukimi për të drejtat e fëmijëve, Qasje ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara, Hap pas hapi, World Child, Aktivitete verore, Mësimdhënës mentor, Educ Aid, Psiko sociale, ECDL etj. Në këtë pyetje, mësimdhënësit kanë dhënë më shumë se një përgjigje.


Grafikoni në vijim *paraqet pjesëmarrjen në programet e trajnimit sipas grup-moshave* nga i cili rezulton se grup-moshat nga 41-60 vjet kanë marrë pjesë më shumë në programe specifike si: nga FSDEK, TEMA, programi MNQ krahasuar me moshat më të reja prej 21 – 40 vjeç. Këto gjetje reflektojnë në nevojën për programe specifike të trajnimit dhe përfshirjen masive të mësimdhënësve.



Grafiku nr. 8. Vijimi i trajnimeve të mësimdhënësve përfshirës sipas grup moshave

Edhe në aspektin e përvojës në punë, përqindja më e lartë përfshin mësimdhënësit të cilët kanë një përvojë mbi 30-vjeçare. Shprehur në përqindje rreth 37%. 18.8% të të anketuarve kanë një përvojë 21-25 vjeç, kurse 12.5% kanë prej 21-25 vjet. Me nga 6.2% përfaqësohen ata që kanë 11-15 dhe 26-30 vjet përvojë.

- *Numri i nxënësve në klasat përfshirëse* është një faktor i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke pasur parasysh faktin se përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore kërkon akomodim të nevojshëm. Të dhënat për numrin e nxënësve në *klasat përfshirëse* janë: Klasat përfshirëse me 36-40 nxënës përfaqësohen me 21.9%, kurse nga 26-30 dhe 31-35 me nga 12.5%. 28.1% të të anketuarve kanë deklaruar se kanë nga 21-25 nxënës në klasë. Klasat me 16-20 nxënës përfaqësohen me 15.6%, Dy mësimdhënës nuk janë deklaruar fare. Grafiku në vazhdim tregon përqindjen e numrit të nxënësve në klasë.




Grafiku nr. 9. Numri i nxënësve në klasat përfshirëse

Bazuar në këto të dhëna, shumica e klasave përfshirëse janë të mbingarkuara me nxënës, gjë e cila vështirëson mësimdhënien dhe ndikon drejtpërdrejtë në pamundësinë e mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

- *Regjistrimi i nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta – përfshirëse*: Iniciativa për regjistrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta tregon vetëdijesimin e akterëve relevantë për përgjegjësitë e tyre në përmbushjen e obligimeve dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Andaj për këtë aspekt kemi kërkuar përgjigje nga mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësve të përfshirë.


Regjistrimi e fëmijës në klasë është bërë në shumicën e rasteve me propozimin e prindit. Në disa raste ky propozim ka qenë rekomandim i vet mësuesit përfshirës nga takimet me prindër. Sipas përgjigjeve të dhëna nga mësimdhënësit, në 83.9% të rasteve vet prindërit propozojnë përfshirjen në klasë të rregullt. Me 32.3% radhitet propozimi i bërë nga ana e drejtorit, kurse me 22.6% nga qendra burimore. Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Ekipi profesional, përfaqësohen me një shkallë shumë të ulët përqindjeje, 9.7%, përkatësisht 3.2%. Në grupin e propozuesve tjerë bëjnë pjesë: shoqata Down Syndrome Kosova për tri raste dhe një rast pedagogia e shkollës.



Grafiku nr. 10. Përgjigjet e mësimeve përfshirës për iniciativat në përfshirjen e nxënësve

- Pyetja për gatishmërinë e *pranimit të nxënësve me NVA në klasë* shpreh vullnetin dhe përgjegjësitë që kanë mësimeve për përfshirje.

Lidhur me mënyrën e *pranimit të nxënësve përfshirës në klasë*, numri më i madh i mësimeve, rreth 70% prej tyre janë shprehur se këtë e kanë bërë me dëshirë, kurse 21.9% me propozim. Një mësime është përgjigjur se nxënësin e ka pranuar në klasë me detyrim, kurse dy të tjerë nuk janë përgjigjur fare.




Grafiku nr. 11. Pranimi i nxënësit në klasë nga mësimdhënësi përfshirës

Përfshirja e nxënësit brenda klasës, kushtëzohet me identifikimin e nevojave për mbështetje të nxënësit, por edhe të mësimdhënësit përfshirës si realizues direkt i procesit.

Lidhur me këtë bashkëpunim dhe mbështetjen që ofrojnë Qendrat Burimore për shkollat e rregullta-përfshirëse e që reflekton në mbështetjen e nxënësve të përfshirë, ne kemi marrë të dhëna nga grupet e mësimdhënësve përfshirës dhe prindërit:

- Zakonisht *përfshirja e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në klasë kërkon modifikim të mësimdhënies*. 53.1% nga mësimdhënësit e anketuar janë përgjigjur se kanë ndryshuar qasjen dhe metodologjinë në procesin e mësimdhënies, kurse 31.2% shprehen se nuk kanë ndryshuar asgjë. Nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje 15.6% prej tyre.

- Nga mbi 50% të mësimeve të deklaruar, ndër *ndryshimet më të theksuara* për të cilat shprehen 42.1% të mësimeve është qasja individuale ndaj nxënësit të përfshirë, 21.1% të mësimeve tjerë deklarohen se ata përdorin metoda më të përshtatshme, kurse 10% prej tyre janë përgjigjur se ata kanë ndikuar në ndryshimin e klimës së klasës për pranimin e nxënësit me NVA. Pesë mësime nuk janë përgjigjur fare. Në grafikun në vazhdim janë paraqitur përgjigjet e dhënë lidhur me ndryshimet e bëra në procesin e mësimit.




Grafiku nr. 12. Ndryshimet në procesin e mësimit

- Në pyetjen se *kush ju ofron mbështetje për përfshirjen e FNV në klasë*, sipas gjetjeve, mësimit të përfshirës më së shumti bashkëpunojnë me prindërit. Për këtë shprehen 44.4% të

mësimeve. Për mbështetjen e nxënësit të përfshirë, 29.6% bashkëpunojnë me kolegët e punës, 22.2% me drejtorin e shkollës, 14.8% me mësuesin udhëtues, 11.1% me asistenten dhe me nga 7.4% me mësuesin profesional për të verbër dhe me pedagogen. Në dy raste mësimit kanë deklaruar se nuk bashkëpunojnë me askënd dhe gjithë mbështetjen dhe


angazhimin për nxënësin e përfshirë, e bëjnë vet pa ndihmën e askujt.



Grafiku nr. 13. Personat me të cilët bashkëpunojnë mësimdhënësit përfshirës.

Shumë pak nga mësimdhënësit përfshirës kanë potencuar mbështetjen nga mësimdhënësit udhëtues dhe qendrat burimore (rreth 26%) nga të cilët pritet mbështetje kryesore.

Sipas *mësimdhënësve përfshirës*, vetëm 12% nga ta janë të kënaqur me nivelin e mbështetjes së ofruar nga mësimdhënësit udhëtues. Pjesa tjetër e pjesëmarrësve nuk janë të kënaqur, madje një numër i madh nga ta (32%) deklarohen se „nuk ka mësues udhëtues”, edhe pse kontaktet me këta mësimdhënës i kemi siguruar nga listat e marra nga mësimdhënësit udhëtues, për të cilët janë deklaruar se i mbështesin.



Grafiku nr. 14. Niveli i kënaqshmërisë së mbështetjes nga mësime dhënësi udhëtues


Ndërsa për shërbimet e mbështetjes pjesëmarrësit në hulumtim janë deklaruar se mësime dhënësi udhëtues *më tepër i mbështetin me materiale mësimore dhe në hartimin e planit individual të arsimit.*

- Për *orarin e takimeve* ata shprehën se nuk kanë ndonjë orar të caktuar. Disa i kanë mbajtur ato një herë në muaj, pastaj të tjerët një herë në javë nga një orë, së paku dy orë në muaj, së paku dy orë në javë, tri herë në muaj nga një orë, një herë në muaj, dy herë në vit, pa orar të caktuar por sipas nevojës etj. 50% e tyre janë deklaruar se nuk kanë pasur fare takime. Nga të gjeturat e hulumtimit, mund të konkludojmë se nuk kishte një orar të takimeve të planifikuar së bashku nga mësime dhënësi.

Vlen të theksohet se mësime dhënësi që kanë përfshirë nxënës me dëmtime në të parë janë të kënaqur me mbështetjen që iu ofrojnë mësime dhënësi udhëtues. Ndërsa për nxënësit me

dëmtime në të dëgjuar dhe në të folur, mësimitdhënësit përfshirës shprehen se përveç mbështetjes me aparate dëgjimi për fëmijët, nuk kemi mbështetje tjetër nga mësimitdhënësi udhëtues.

- Në pyetjen se për *çfarë mbështetje keni nevojë më tepër nga mësimitdhënësi udhëtues?*, kërkesë kryesore e mësuesve përfshirës për mbështetje nga mësuesi udhëtues është furnizimi me material mbështetës, literaturë të përshtatshme dhe mjete e pajisje të tjera të nevojshme për mësimitdhënie dhe aktivitete për nxënësit përfshirës. Për këtë janë deklaruar 40% prej tyre. Këshilla dhe konsultime në avancimin e nxënësit kanë kërkuar 20% të mësuesve, kurse për hartimin e planeve individuale, 15%. Disa nga ta, nga rreth 5% kanë përmendur nevojën për qasje dhe metodologji e madje edhe angazhim të drejtpërdrejt me fëmijët me nevoja të veçanta dhe nevojën për angazhimin e asistentes dhe takime më të shpeshta me mësuesin udhëtues. Nuk janë përgjigjur fare 10% të mësimitdhënësve.




Grafiku nr. 15. Nevojat e mësimitdhënësve përfshirës për mbështetje nga mësimitdhënësi udhëtues

3.2.3. Rezultatet e hulumtimit me prindërit e nxënësve të përfshirë

Që rezultatet e hulumtimit të jenë më të besueshme, në hulumtim kemi përfshirë edhe prindërit e nxënësve të përfshirë si faktor i rëndësishëm i mbështetjes së nxënësve. Nga ta kemi gjetjet për moshën, nivelin e shkollimit dhe pjesëmarrjen në trajnime. Pyetëtorët i kanë plotësuar 26 prindër.

Prej tyre 14 ose 53.8% janë të gjinisë femërore, kurse 11 apo 42.8% të gjinisë mashkullore. Një prind nuk është përgjigjur fare në këtë pyetje.


Numri më i madh i tyre apo 46.2% i takojnë moshës prej 31-40 vjeç, 23.1% moshës 41-59 vjeç, kurse 7.7% kanë më tepër se 60 vjet, siç tregon edhe grafiku në vazhdim.



Grafiku nr. 16. Moshë e prindërve të nxënësve të përfshirë

Niveli arsimor i prindërve të këtyre nxënësve është i ndryshëm. Nga 26 prindër, 12 apo 46.2% prej tyre, kanë të kryer shkollën fillore, 8 apo 30.8% atë të mesme, kurse vetëm 4 apo 15.4% janë me fakultet. Me SHLP është një prind, kurse një tjetër nuk është deklaruar fare.


- Për ofrimin e mbështetjes së fëmijëve të tyre, por edhe të shkollës, është e rëndësishme *ofrimi i programeve të trajnimit për prindërit*. Pjesëmarrja në trajnime e prindërve është shumë e ulët. Nga 26 pjesëmarrës në hulumtim, vetëm 7 prej tyre apo 26.9% kanë deklaruar se kanë ndjekur ndonjë trajnim, ndërsa pyetjes vijuese se *cilat janë ato trajnime*, i janë përgjigjur vetëm 3 prej tyre.



Grafiku nr. 17. Pjesëmarrja e prindërve në trajnime

Organizimi i trajnimeve për prindërit e fëmijëve me NVA është detyrë e Qendrave Burimore, por sipas gjetjeve të hulumtimit, një numër i vogël i prindërve kanë marrë pjesë në programe trajnimi.

- Edhe prindërit i janë përgjigjur pyetjes që ka të bëjë me bashkëpunimin dhe mbështetjen për qasje ndaj fëmijës. Rreth 88.5%, kanë deklaruar se bashkëpunojnë dhe kërkojnë ndihmë e këshilla nga mësuesi i klasës, 2 prindër apo 7.7% bashkëpunojnë me asistenten e nxënësit dhe Organizatën Down Syndrome Kosova, kurse vetëm 1 (3.8%) prind bashkëpunon me mësuesin udhëtues. Nga këto të dhëna vërehet se prindërit fare pak bashkëpunojnë me mësuesin udhëtues, ndërsa shumica e prindërve janë deklaruar se janë takuar ndonjëherë me ta.




Grafiku nr. 18. Bashkëpunimi i prindërve

Bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së mësuesin udhëtues, ata duhet të bashkëpunojnë edhe me prindërit e nxënësve të përfshirë për mbështetjen e tyre.

Lidhur me pjesëmarrjen e prindërve për hartimin e PIA-s, 18 prej tyre apo 69.2% janë shprehur se ata marrin pjesë në hartimin e planit, kurse 8 apo 30.8% nuk e bëjnë këtë.

Në pyetjen se kush ka iniciuar përfshirjen e fëmijës në klasë të rregullt, kemi marrë përgjigje edhe nga prindërit. Sipas përgjigjeve të *prindërve*, në shumicën e rasteve përfshirja e fëmijëve në klasa të rregullta bëhet me iniciativën e prindit. Kjo përqindje arrin në 65.4%. Në vendin e dytë, me një përqindje shumë më të ulët rreth 27% pason shkolla e rregullt, kurse Qendra Burimore dhe ekipi profesional kanë një përqindje të barabartë, 3.8% siç shihet edhe nga grafiku në vazhdim. Por të gjithë prindërit (26) e përfshirë në hulumtim janë deklaruar se me dëshirë e kanë aprovuar përfshirjen e fëmijës në klasë të rregullt.



Grafiku nr. 19. Përgjigjet e prindërve për iniciativën e përfshirjes së FNV në klasën e rregullt

Nga ky aspekt vërehet përparim i dukshëm i vetëdijesimit të prindërve krahasuar me hulumtimin e bërë nga Instituti Pedagogjik i Kosovës në vitin 2008 (hulumtimi: Klasat e bashkëngjitura, mundësi integrimi apo segregimi për fëmijët me nevoja të veçanta në Kosovë, IPK) ku shumica e prindërve preferonin shkollat speciale apo klasat e bashkëngjitura.

3.3. Rezultatet e nxënësve të përfshirë

Në këtë kapitull do të prezantohen rezultatet e arritshmërisë dhe të socializmit të nxënësve të përfshirë sipas opinioneve të pjesëmarrësve në hulumtim.


3.3.1. Rezultatet e arritshmërisë së nxënësve të përfshirë

Regjistrimi i nxënësve në arsim të rregullt nuk e përmbyll obligimin ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. Përkundrazi, shton obligimin ndaj të gjithë faktorëve me ndikim që nxënësi të trajtohet drejt, të mirëpritet dhe të zhvillojë potencialet e tij. Përderisa nuk është bërë ndonjë vlerësim i gjithanshëm profesional i nxënësit, vlerësimi i njëanshëm mund të jetë joobjektiv. Megjithatë, përmes këtij hulumtimi kemi marrë opinionet nga grupet e pjesëmarrësve në hulumtim, për të kuptuar nivelin e përparimit të këtyre fëmijëve duke kërkuar vlerësim krahasues nga ana e tyre.

- Në pyetjen: *A mund të bëni një vlerësim krahasues të arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në fillim të procesit dhe tani?* Nga përgjigjet e dhëna të *mësimdhënësve përfshirës* lidhur me vlerësimin krahasues të nxënësit, vërehet se 87.5% të tyre kanë bërë vlerësim krahasues të rezultateve të nxënësit në fillim të regjistrimit në klasë dhe tani, kurse 3.1% nga ta nuk e kanë bërë një vlerësim të tillë. Nga të gjithë mësuesit e anketuar, 3 nuk janë përgjigjur fare.

Sipas atyre që kanë bërë një vlerësim të tillë, rezulton se në 56.2% të rasteve vërehet një përparim i ngadalshëm, kurse në 31.2%

përparim shumë i shpejt. 9.4% nga mësimdhënësit nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje.




Grafiku nr. 20. Niveli i përparimit të nxënësit.

- Ndërsa për notimin e nxënësve, sipas deklarimit të mësimdhënësve ata nuk aplikojnë kriteret e njëjta. Notimin e nxënësit 43.3% të mësuesve përfshirës e bëjnë sipas rezultateve të PIA-s, 36.7% sipas krahasimit me nxënësit tjerë të klasës, kurse 30.3% të tyre janë shprehur se notimin e nxënësit e bëjnë në një mënyrë tjetër. Me notimin tjetër nënkuptohet kryesisht notimi me stimulim. Vërehet se numri më i madh i mësimdhënësve nuk kanë njohuri për mënyrën e vlerësimit.

- Sipas përgjigjeve të 60% të mësuesve udhëtues, rezultatet e arritshmërisë së njohurive të nxënësit të përfshirë janë të mira.

Kurse 40% prej tyre i kanë konsideruar ato si të kënaqshme.



Grafiku nr. 21. Niveli rezultateve të arritshmërisë sipas mësimdhënësve udhëtues dhe përfshirës


Po ashtu, lidhur me rezultatet e fëmijëve të tyre janë përgjigjur edhe *prindërit*. Nga gjithsej 26 prindër, 20 apo 76.9% deklarojnë se janë të kënaqur me rezultatet e fëmijës në shkollë, kurse 5 apo 19.2% thonë se nuk janë të kënaqur. Një prind nuk është deklaruar fare. Sipas përgjigjeve të dhëna nga prindërit, vërehet se rezultatet më të larta mësimore arrihen në shkollën e rregullt, aty ku fëmija është tani. Nga gjithsej 22 prindër të deklaruar, 21 prej tyre janë shprehur se në shkollën speciale apo klasën e bashkëngjitur ku i kishin fëmijët më parë sukcesi i tyre ishte më i ulët se në shkollën e rregullt. Vetëm njëri nga ta u shpreh se fëmija i tij kishte arritje më të lartë në shkollën speciale. Nuk kanë dhënë as një lloj përgjigjeje, 8.3% të prindërve.

3.3.2. Rezultatet e socializimit të nxënësit të përfshirë

Rezultatet e socializimit të nxënësit përfshirës, sipas 43.8% të *mësimdhënësve të klasave përfshirëse* janë shumë të mira, kurse 40.6% prej tyre deklarojnë se ato janë të mira. Në 12.5% të rasteve, nxënësi ka rezultate të kënaqshme. Një mësimdhënës nuk është përgjigjur fare.

Rezultatet e socializimit të nxënësve të përfshirë, sipas përgjigjeve të *mësimdhënësve përfshirës* janë të një niveli më të lartë krahasuar me rezultatet e arritshmërisë.

Po ashtu për socializimin e nxënësve të përfshirë janë deklaruar edhe *mësimdhënësit e udhëtues*. Sipas tyre, rezultatet janë këto të paraqitura në grafikun në vijim:



Grafiku nr. 22. Niveli rezultateve të socializimit sipas mësimdhënësve udhëtues dhe përfshirës

Nëse bëjmë krahasimin e rezultateve të dala për arritshmërinë dhe socializimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, ndërmjet *mësimdhënësve përfshirës* dhe atyre *udhëtues* vërejmë se mësimdhënësit përfshirës vlerësojnë më lartë përparimin e tyre.

- Një element i rëndësishëm për nxënësin e përfshirë në klasën e rregullt, është *krijimi i klimës pozitive dhe mikpritëse brenda klasës*. Mënyra e pranimit të tij dhe qëndrimi i nxënësve të tjerë ndikon drejtpërdrejt në gjendjen emocionale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, gjë që reflekton edhe në rezultatet e nxënësit. Rreth 56.2% e mësimdhënësve shprehën se nxënësit e tjerë e ndihmojnë nxënësin e përfshirë dhe 41% janë shprehur se e duan atë. Rreth 3% e mësimdhënësve nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Një tregues i rëndësishëm i përshtatjes së nxënësit me nevoja të veçanta në shkollë, është edhe gjendja e tij emocionale. Një pyetje e tillë iu është bërë prindërve.

Një shpërndarje përafërsisht e njëjtë e opinioneve të *prindërve* vërehet nga përgjigjet që ata kanë dhënë lidhur me gjendjen e tanishme emocionale të fëmijëve të tyre. 34.6% të prindërve janë deklaruar se fëmija ndihet shumë i gëzuar në krahasim me gjendjen e mëparshme (para përfshirjes), 30.8% i gëzuar, kurse 26.9% nga ta kanë deklaruar se tek fëmija i tyre nuk ka kurrfarë ndryshimi, pra gjendja është e njëjtë. Një prind pohon se fëmija i tij është i shqetësuar, kurse një tjetër prind nuk ka dhënë fare përgjigje.

Po ashtu duke pasur parasysh edhe ndikimin e rrethit në edukimin e fëmijëve, kemi marrë opinione nga *prindërit*. Sa i përket sjelljes së fëmijës, një numër i madh i prindërve apo 46.2% janë shprehur se sjelljet e fëmijës tani janë shumë më të mira se më parë. Për sjellje më të mira janë deklaruar 38.5%, kurse 15.4% mendojnë se fëmija ka sjellje të njëjta sikur edhe më parë, pra nuk vërehet ndonjë ndryshim.



Grafiku 23. Opinione të prindërve për sjelljet e fëmijëve

3.4. Identifikimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve të pjesëmarrësve në hulumtim për fuqizimin e mbështetjes së nxënësve të përfshirë

Nga grupet e mësimdhënësve përfshirës, të mësimdhënësve udhëtues dhe prindërve të nxënësve të përfshirë në hulumtim kemi kërkuar që të deklarohen për vërejtjet që kanë në realizimin

me sukses të procesit të përfshirjes dhe sugjerimet e tyre për përmbushjen e nevojave në realizimin me sukses të misionit të tyre.

Vështirësitë (vërejtjet) e pjesëmarrësve në hulumtim

Mësimdhënësit përfshirës	Mësimdhënësit udhëtues	Prindërit
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Integrimi i nxënësit në klasë; ▪ Numri i madh i nxënësve në klasë; ▪ Koha e pamjaftueshme për t'iu përkushtuar në nivelin e duhur fëmijëve me nevoja të veçanta; ▪ Mungesa e materialit didaktik; ▪ Mosnjohja e specifikave të FNV; ▪ Përshtatja e mësimdhënies FNV; ▪ Mungesa e bashkëpunimit me prindër; ▪ Mungesa e bashkëpunimit me 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ngarkesat me numër të madh të nxënësve dhe terreni i gjerë; ▪ Mungesa e automjetit; ▪ Mungesa e shpenzimeve të rrugës; ▪ Mungesa e përkrahjes nga shërbimet e mbështetjes; ▪ Mungesa e ekipit vlerësues; ▪ Mungesa e shërbimit profesional në shkolla; ▪ Numri i vogël i mësuesve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mosinteresim i drejtorit të shkollës; ▪ Mungesa e literaturës për FNV; ▪ Numri i madh i nxënësve në klasë; ▪ Mungesa e ekipeve për vlerësimin e fëmijëve; ▪ Mungesa e asistentes; ▪ Mungesa e shërbimit profesional; ▪ Mësuesja s'ka kohë të merret me

kolegë; ■ Mungesa e përkrahjes nga drejtori; ■ Mungesa e asistentit në klasë; ■ Mungesa e mbështetjes nga institucionet;	udhëtues; ■ Puna e mësuesit udhëtues nuk mirëpritet nga stafi dhe udhëheqja e shkollës; ■ Detyrat e mësuesit udhëtues ende nuk janë konkrete dhe të modifikuara në mënyrë të drejtë;	fëmijën tim;
---	--	--------------

Sugjerimet e pjesëmarrësve në hulumtim

Mësimdhënësit përfshirës	Mësimdhënësit udhëtues	Prindërit
■ Nxënësit të vlerësohen në vazhdimësi nga ekspertët; ■ Sigurimi i ekspertëve; ■ Mësuesi udhëtues të caktojë orar sipas nevojave dhe ti përmbahet orarit, të	■ Organizimi i trajnimeve; ■ Bashkëpunimi me komunat, DKA-të të jenë të involvuara në proces; ■ Përmirësim i kushteve të punës për	■ Angazhim më i madh i mësuesit udhëtues; ■ Angazhim edhe i mësimdhënësve të tjerë; ■ Trajnimi i mësimdhënësve ■ Aktivitete të pakta fizike; ■ Përkrahje e plotë nga mësimdhënësi

<p>angazhohet më shumë;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nevojitet logopedi ▪ Mbështetja në gjuhën e shenjave ▪ Të ketë mjek, psikolog, psikiatër, fizioterapeut, ekspert të ed. special, pedagog; ▪ Planifikim i takimeve nga qendra burimore; ▪ Mësim shtesë, jashtë orarit, etj. ▪ Mirë që po bëhet ky hulumtim, po interesohet dikush 	<p>mësuesit</p> <p>Udhëtues,</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizim më i mirë i qendrave burimore; ▪ Funkcionalizimi i ekipeve bërthamë; ▪ Kyçja e një psikologu në çdo qendër; ▪ Punësim i punëtorit social, etj. 	<p>dhe shokët;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fuqizimi i OJQ-ve që merren me FNV; ▪ Hartimi i literaturës; ▪ Të monitorohet plani strategjik i gjithpërfshirjes për FNV nga MASHT-i dhe IPK; ▪ Pajisja me mjete të përshtatshme mësimore ; ▪ Material sa më të lehtë komunikimi; ▪ Aftësim për punë ▪ Aktivitete të ndryshme; ▪ Interesim dhe mirëkuptim më i madh nga mësuesi i klasës,etj.
---	--	--

Analiza e kësaj tabele tregon se procesi i përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta po ballafaqohet me vështirësi të shumta, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në nivelin e zhvillimit të potencialeve të tyre.

3.5. Vëzhgimi në orët mësimore

Me që ishim të vetëdijshëm se vëzhgimi në një orë mësimore nuk mjafton për të verifikuar të gjitha kriteret e nevojshme për matjen e zhvillimit të potencialeve të nxënësve dhe pasi që nuk kishim bërë një vlerësim paraprak për të bërë krahasime, ne jemi përqendruar vetëm në disa kriteret objektive të cilat ishin të dukshme dhe të matshme. Për të pasur një pasqyrë të nxënësve të përfshirë brenda klasës, kemi vëzhguar: akomodimin e nxënësve brenda klasës, planet mësimore, mjetet mësimore, performancën e nxënësve, bashkëpunimin në grup, dosjet e nxënësve dhe vlerësimin.

Akomodimi i nxënësve në klasë

Në 17 nga gjithsej 19 klasat përfshirëse në të cilat është bërë vëzhgimi, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ishin të akomoduar në vende të përshtatshme brenda klasës. Në një rast kemi hasur nxënësin me nevoja të veçanta të veçuar nga nxënësit tjerë, në fund të bankës dhe i dalluar nga të tjerët – pa uniformë („asaj i pëlqen të rri vetëm në atë bankë dhe ajo nuk ka uniformë”, shpreheshin nxënësit tjerë dhe kujdestari i klasës). Ndërsa rasti tjetër, nga gjithsej 37 nxënës sa kishte klasa, 6 nxënës ishin të identifikuar me nevoja të veçanta arsimore. 4 nga ta ishin të ulur në një grup të veçantë (mësimdhënësja e klasës për këtë deklaroi se punon me një plan të përbashkët dhe të përshtatur për nivelin e grupit) ndërsa 2 nxënës të tjerë (sipas saj „më të përparuar”) ishin akomoduar brenda grupeve të nxënësve pa nevoja të veçanta.

Mësimdhënësit deklaroheshin shumë të kujdesshëm për respektimin e nevojave të nxënësve dhe pozitën e tyre brenda grupit apo bashkësisë së klasës.

Planet mësimore

Gjatë vëzhgimit është konstatuar se 11 nga mësimdhënësit përfshirës nuk hartojnë plane individuale. 5 nga ta janë deklaruar se punojnë individualisht me nxënësit me nevoja të veçanta dhe e përshtatin planin gjatë metodologjisë së punës. Ndërsa 7 të tjerët hartojnë plane individuale për disa lëndë apo të gjitha lëndët mësimore, varësisht nga nevojat e nxënësve. 1 mësimdhënësi harton plan grupor për grupin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Mjetet mësimore

Në të shumtën e rasteve (në 11 klasa), nxënësit me nevoja të veçanta (dëmtime intelektuale) nuk kanë mjete mësimore të veçanta me përjashtim të teksteve mësimore të cilat i përdorin ato të klasave më të ulëta. 3 mësimdhënësit janë deklaruar se përgatisin vetë materiale mësimore. Nxënësit me dëmtime të tjera, përdorin mjete ndihmëse varësisht nga lloji i dëmtimit ndërsa tekstet dhe mjetet e tjera mësimore janë të njëjta me nxënësit e tjerë. Në 2 klasa të përfshirë nxënës me dëmtime në të parë përdorin alfabetin e Brajlit. Njëri përdor makinë shkrimi ndërsa një tjetër laptop. Dy nxënës përdorin aparate për dëgjim dhe 1 nxënës me dëmtime fizike përdorë tabelën lëvizëse. Mësimdhënësit potencojnë se nuk kanë mjete mësimore të nevojshme.

Performanca e nxënësit në klasë

Gjatë një ore mësimore jemi munduar të vërejmë interesimin dhe koncentrimin e nxënësve në klasë, pasqyrë kjo që na bënë të kuptojmë edhe përshtatjen e mësimdhënies dhe nxënies. Nga vëzhgimi i nxënësve në klasë, kemi vërejtur se 8 nga ta ishin shumë të koncentruar dhe po ashtu aktivë, 7 nxënës herë pas herë dhe pak aktivë, ndërsa 4 ndonjëherë të koncentruar dhe aspak aktivë.

Bashkëpunimi në grup

Meqë, gjatë orëve të vëzhgimit në shumicën e klasave nxënësit ishin të ulur në formë tradicionale, por sipas mësimdhënësve 10 nxënës me nevoja të veçanta bashkëpunojnë shumë mirë me grup, 3 mirë, 4 pak, ndërsa 2 punojnë çdoherë individualisht ose rrallëherë në grup.

Dosjet e nxënësit

Janë kontrolluar fletoret dhe materialet nga dosjet e disa nxënësve. Meqë disa mësimdhënës nuk kishin dosje të nxënësve, ne morëm edhe mendimin e mësimdhënësve për vlerësim. 7 nxënës tregojnë shumë përparim, 6 nxënës-mesatar, 6 nxënës kanë përparuar pak.

Vlerësimi i nxënësit

Mësimdhënësit shprehnin dilema rreth vlerësimit numerik. 6 nga mësimdhënësit janë deklaruar se bëjnë notim stimulues, 3 në bazë të PIA-s, 6 – vlerësim krahasues me nxënësit e tjerë në klasë, ndërsa 4 notojnë vetëm „sa për ta kaluar klasën”.

Mësimdhënësit që kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta të veçanta arsimore punojnë sipas kapaciteteve të tyre profesionale në qasjen ndaj nevojave të nxënësve, megjithatë, vërehet një pasiguri në punën e tyre, deklarohen për mungesë të mbështetjes së nevojshme dhe mungesë të vlerësimit të punës së tyre.

4. Përfundime

Qendrat burimore në Kosovë të transformuara nga shkollat speciale, ndër hallkat kryesore në zinxhirin e sistemit të mbështetjes së shkollave të rregullta – përfshirëse, funksionojnë me kapacitete të kufizuara krahasuar me nevojat për mbështetje dhe mbarëvajtje të këtij procesi. Ekipet e shërbimeve të mbështetjes brenda tyre nuk janë aktive në nivelin e duhur për ofrimin e mbështetjes së nevojshme për shkollat e rregullta të cilat kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta, arsimore. Ndërsa një mbështetje cilësore dhe bashkëpunim korrekt me qendrën burimore nuk e potencojnë as shumica nga drejtorët e shkollave të rregullta – përfshirëse. Qendrat burimore nuk kanë realizuar aktivitete të nevojshme për ngritjen e nivelit të vetëdijesimit dhe përgatitjen e shkollave të rregullta - përfshirëse. Pësha kryesore për mbështetje të nxënësve të përfshirë në shkolla të rregullta – përfshirëse, iu bartet mësimdhënësve udhëtues.

Mësimdhënësit udhëtues janë në numër shumë të vogël për t'i mbuluar nevojat për mbështetje të të gjithë fëmijëve të

identifikuar. Po ashtu, ata deklarohen se i kanë mundësitë e kufizuara për realizimin e detyrave të tyre në terren si pasojë e mos përmbushjes së obligimeve teknike dhe financiare ndaj nevojave të tyre për udhëtimet në terren. Mungesa e planifikimit të përbashkët bazuar në nevojat dhe llojin e mbështetjes, ka krijuar pakënaqësi tek mësimitdhënësit përfshirës dhe prindërit e nxënësve të përfshirë. Shumica e tyre deklarohen të pakënaqur me mbështetjen nga mësimitdhënësi udhëtues, madje rreth gjysma e të anketuarve shprehen se nuk kanë kurrfarë mbështetje nga mësimitdhënësit udhëtues. Ndërsa pjesa tjetër të cilët deklarohen se marrin ndonjë mbështetje kanë cekur kryesisht mbështetjen me materiale mësimore apo edhe hartim të PIA. Ndërsa, për detyrat e tjera të caktuara për mësimitdhënësit udhëtues si: koordinim të bashkëpunimit, organizim të trajnimeve, mbështetje në orët mësimore, këshillime, nuk e potencojnë as mësimitdhënësit përfshirës por as prindërit. Nga ana tjetër, në shkollat në të cilat kemi realizuar hulumtimin, kishte raste të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta por të cilët nuk gjendeshin në listën e të identifikuarve nga ana e mësimitdhënësve udhëtues, madje mësimitdhënësit e atyre klasave nuk ishin të informuar se në shkollën e tyre kishte klasa që mbështeteshin nga mësimitdhënësi udhëtues. Kjo është pasqyrë e një mosbashkëpunimi të mirëfilltë me shkollën.

Shkollat e rregullta dhe mësimitdhënësit të cilat kanë përfshirë nxënës me nevoja të veçanta arsimore nuk kanë ndonjë dokument (vendim) apo përkrahje të veçantë nga MASHT ose DKA që do t'i obligonte edhe stimulonte shkollat për përfshirje (përveç ligjit i cili nuk është plotësuar me ndonjë akt tjetër

nënligjor) krahasuar me shkollat tjera të rregullta jo përfshirëse. Kështu, shpesh herë drejtorët e shkollave të rregullta – përfshirëse, përveç se kanë kryer një obligim ligjor - kanë regjistruar nxënës me nevoja të veçanta arsimore, shumica nga ta, në nivel shkolle nuk kanë ndërmarrë aktivitete tjera për ofrimin e mbështetjes gjë që rezulton me mungesën e përgatitjes së tyre udhëheqëse, morale dhe shoqërore, të nevojshme për këtë proces. Ata nuk janë mikpritës për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, nuk bashkëpunojnë me qendrat burimore dhe nuk i mirëpresin mësimdhënësit udhëtues, dhe pasojat bien tek nxënësit të cilët detyrohen të lëvizin nga klasa në klasë dhe t'i ndërrojnë mësimdhënësit apo të kthehen përsëri në shkollën speciale.

Rezultatet e procesit të përfshirjes, kryesisht mbeten përgjegjësi e mësimdhënësve përfshirës dhe varen nga përgatitja profesionale, gatishmëria, vullneti dhe mundësitë e tyre. Me gjithë vështirësitë, shumica e prej tyre kanë shprehur gatishmërinë për pranimin e nxënësve me nevoja të veçanta në klasë por vërehet një pasiguri në punë si rezultat i mangësive përgatitore gjatë shkollimit, mungesës së trajnimeve të nevojshme, ekspertëve për konsultime dhe vlerësimit të punës së tyre. Mësimdhënësit përfshirës nuk kanë mbështetjen e duhur nga shkolla e as nga qendra burimore për t'iu ofruar shërbime të nevojshme nxënësve me nevoja të veçanta.

Megjithatë, rezultatet e nxënësve të përfshirë, sipas opinionëve të pjesëmarrësve në hulumtim janë shpresëdhënëse se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore mund të përparojnë në shkolla të

rregullta por nevojitet sigurimi i mbështetjes së nevojshme për zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre dhe ngritjen e cilësisë.

Mund të themi se edhe niveli i vetëdijesimit të prindërve të nxënësve të përfshirë ka shënuar ngritje duke pasur parasysh faktin se shumë nga ta kanë iniciuar regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkolla të rregullta dhe janë bashkëpunëtorët më të ngushtë të mësimdhënësve përfshirës. Po ashtu, disa prindër me vetëfinancim kanë angazhuar asistent në klasë për fëmijët e tyre.

Mund të përfundojmë se mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta është në nivel jo të kënaqshëm. Andaj, shtrohet pyetja se çka mund të bëjmë që të përmirësohet gjendja dhe të zhvillohet sistemi i mbështetjes? Shumë çështje mund të rregullohen vetëm me zbatim të legjislacionit dhe vendimeve në fuqi, por nevojitet ndërgjegjësim i akterëve relevantë, ndërsa për disa të tjera nevojitet plotësim dhe fuqizim i politikave arsimore, si dhe zbatimi i tyre në praktikë.

5. Rekomandime

Raporti i rezultateve të këtij hulumtimi është prezantuar në punëtorinë e organizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës më 3 prill 2013, në të cilën pjesëmarrës ishin akterë të grupeve relevante të rëndësishme në zhvillimin e procesit të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta, si: zyrtarë të MASHT- njësia për Arsim Special, përfaqësues nga DKA, drejtorë dhe përfaqësues të qendrave burimore, drejtorë të

shkollave të rregullta – përfshirëse, mësimdhënës udhëtues, mësimdhënës përfshirës, prindër të nxënësve të përfshirë, përfaqësues nga OJQ dhe IPK.

Nga gjetjet e hulumtimit dhe sugjerimet e grupeve punuese në punëtori, për zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi, iu rekomandojmë:

5.1. Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- Të hartojë politika konkrete për mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe të fuqizojë sistemin e mbështetjes;
- Të mbështesë funksionimin e qendrave burimore (ekipet për shërbimet e mbështetjes) dhe të monitorojë realizimin e detyrave të tyre;
- Të rritë numrin e mësimdhënësve udhëtues në qendrat burimore, bazuar në nevojat e nxënësve për mbështetje;
- Të përcaktojë proporcionin mësimdhënës udhëtues – nxënës me NVA, mbi bazën e nevojës për mbështetje;
- Të përcaktojë në mënyrë precize detyrat, format dhe nivelin e mbështetjes së mësimdhënësve udhëtues;
- Të sigurojë kushte teknike për realizimin e detyrave në terren të mësimdhënësve udhëtues;
- Të punësojë ekspertë të fushave specifike në qendrat burimore;

-
- Të organizojë fushata në ngritjen e vetëdijes për përfshirje të nxënësve me NVA në shkolla të rregullta;
 - Të përcaktojë sistemin e monitorimit të procesit të përfshirjes;
 - Të stimulojë shkollat e rregullta të cilat përfshijnë nxënës me nevoja të veçanta arsimore;
 - Të investojë në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve udhëtues dhe mësimitdhënësve përfshirës;
 - Të përcaktojë standarde për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
 - Të hartojë udhëzues për punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
 - Të sigurojë mësimitdhënës mbështetës apo asistentë në klasat përfshirëse bazuar në identifikimin e nevojave.

5.2. Zyrave të inspektimit:

- Të monitorojnë dhe inspektojnë punën e qendrave burimore, shkollave të rregullta – përfshirëse dhe bashkëpunimin e tyre, në vazhdimësi;
- Të monitorojnë përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollë dhe të zbatojnë masa të nevojshme në rastet e mos përfshirjes;

-
- Të monitorojnë nivelin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta të përfshirë në shkolla të rregullta;
 - Të monitorojnë hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e PIA-as.

5.3. Drejtorive komunale të Arsimit:

- Të formojnë dhe funksionalizojnë ekipet për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Të punësojnë koordinatorë për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Të bashkëpunojnë me qendrat burimore;
- Të trajnojnë mësimdhënësit për qasje gjithëpërfshirëse dhe t'i licencojë ata;
- Të identifikojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Të trajnojnë zyrtarët komunal dhe drejtorët e shkollave të rregullta për rolin e tyre në mbështetje të procesit të gjithëpërfshirjes në arsim;
- Të organizojnë aktivitete të përbashkëta të qendrave burimore dhe shkollave të rregullta;
- Të organizojnë aktivitete për ngritjen e vetëdijesimit për gjithëpërfshirje në arsim;
- Të rrisin buxhetin për stimulim të shkollave të rregullta – përfshirëse dhe mësimdhënësve përfshirës.

5.4. Drejtorëve të qendrave burimore:

- Të funksionalizojnë dhe monitorojnë ekipet për shërbimet e mbështetjes;
- Të sigurojnë trajnime për ekipet e shërbimeve të mbështetjes dhe mësimdhënësit udhëtues, bazuar në specifikat e shërbimeve brenda qendrave burimore;
- Të monitorojnë dhe fuqizojnë mbështetjen e punës së mësimdhënësve udhëtues;
- Të organizojnë aktivitete bashkëpunimi me shkollat përfshirëse dhe t'i mbështesin ato;
- Të organizojnë trajnime specifike për shkollat e rregullta – përfshirëse (stafin, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, komunitetin dhe OJQ);
- Të organizojë aktivitete për ngritjen e vetëdijes për përfshirje dhe rolin e qendrave burimore në sistemin arsimor.

5.4.1. Mësimdhënësve udhëtues:

- Të identifikojnë nevojat për mbështetje brenda shkollës përfshirëse dhe të ofrojnë shërbime të nevojshme;
- Të ofrojnë mbështetje të qëndrueshme bazuar në nevojat e nxënësve dhe mësimdhënësve përfshirës;

-
- Të planifikojnë bashkë me mësimdhënësin përfshirës orarin për bashkëpunim dhe shërbimet mbështetëse;
 - Të kërkojnë shërbime për ngritje profesionale, specializime, vizita studimore, trajnime.

5.5. Drejtorëve të shkollave përfshirëse:

- Të planifikojnë në planin e tyre të veprimit regjistrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të zonës që ata mbulojnë dhe t'i identifikojnë ata;
- Të krijojnë ekipet për identifikimin e nevojave për mbështetje të nxënësve dhe të sigurojnë shërbimet e nevojshme;
- Të bashkëpunojnë me qendrat burimore dhe të kërkojnë mbështetjen e nevojshme nga ato;
- T'i mirëpresin mësimdhënësit udhëtues dhe t'i përkrahin ata në punën e tyre;
- T'i mbështesin mësimdhënësit përfshirës dhe të zvogëlojnë numrin e nxënësve në klasat përfshirëse;
- Të identifikojnë nevojat për trajnimin e mësimdhënësve përfshirës dhe t'i përfshijnë në trajnime të nevojshme;
- Të organizojnë aktivitete të lira përfshirëse;

-
- Të bashkëpunojnë me prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe t'i përfshijë ata në këshillat e prindërve të shkollës;
 - Të bashkëpunojnë me institucione dhe ekspertë për nevojat specifike të nxënësve;
 - Të kërkojnë shërbime nga OJQ e ndryshme që janë të gatshme për mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
 - T'i stimulojnë mësimdhënësit përfshirës;
 - Të organizojnë fushata për ngritjen e vetëdijes gjithëpërfshirëse në shkollat e tyre;
 - Të sigurojnë literaturë të nevojshme për punë me fëmijë me NVA.

5.5.1. Mësimdhënësve përfshirës:

- Të identifikojnë nevojat e nxënësve dhe të përshtatin mësimdhënien;
- Të formojnë dhe udhëheqin ekipin për hartimin dhe vlerësimin e Planit Individual të Arsimit për nxënësit me nevoja të veçanta dhe ta zbatojnë atë.
- Të bashkëpunojnë dhe krijojnë raporte të afërta me prindër të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- Të angazhohen për ngritje profesionale të nevojshme për punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;

-
- Të bashkëpunojnë me mësimdhënësit udhëtues;
 - Të respektojnë individualitetin e nxënësve me nevoja të veçanta;
 - Të vlerësojnë fëmijën me nevoja të veçanta arsimore bazuar në arritjet e PIA.
 - Të krijojnë klimë miqësore brenda klasës;
 - Të bashkëpunojnë me ekspertë të nevojshëm për nevoja specifike të nxënësve;
 - Të përfshijnë fëmijën me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha aktivitetet mësimore brenda klasës.

5.5.2. Prindërve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore:

- Të angazhohen për mbrojtjen e të drejtave që u takojnë fëmijëve të tyre;
- Të bashkëpunojnë me shkollën dhe të jenë aktiv në shkollë;
- Të jenë të hapur me mësimdhënësit për mundësitë dhe nevojat e fëmijëve së tyre dhe t'i përkrahin ata;
- Të marrin pjesë në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e PIA-s për fëmijën e tyre;
- Të përfshihen në trajnime të organizuara për vetëdijesim dhe mbështetje të fëmijëve të tyre.

5.6. Fakultetit të Edukimit:

- Të rishikojë kurrikulën dhe të plotësojë programet me përmbajtje dhe module specifike për gjithëpërfshirje në arsim, në të gjitha degët;
- Të hapen programe të veçanta për përgatitje adekuate për punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
- Të përfshijë në programet e tyre edhe punën praktike në qendrat burimore dhe klasat përfshirëse të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

5.7. OJQ-ve:

- Të mbështesin institucionet arsimore në procesin e gjithëpërfshirjes;
- Të iniciojnë ndryshimet dhe risitë në arsim;
- Të monitorojnë sistemin e mbështetjes për gjithëpërfshirje në arsim;
- Të bashkëpunojnë me shkollat e rregullta - përfshirëse dhe qendrat burimore në funksion të ofrimit të shërbimeve të nevojshme, bazuar në profilet e tyre programore;
- Të identifikojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Të shpërndajnë informatat në institucionet relevante arsimore.

Referencat:

- Konventa mbi të Drejtat e personave me Aftësi të Kufizuar: Prishtinë, (përkthim), 2008
- Kërkime Pedagogjike, Përmbledhje punimesh, nr. 2, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2011
- Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, Prishtinë, gusht 2011
- Ligji për Arsimin Parauniversitar, MASHT, Prishtinë, 2011
- Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar në Kosovë: Zyra e Kryeministrit dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, 2008
- Musai, Dr. Bardhyl: Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies, “Eurolindja”, Tiranë,1996
- Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2010-2016 (PSAK): MASHT Prishtinë, 2010
- Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010-2015: MASHT, Prishtinë, 2010
- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017. MASHT, Prishtinë, 2007
- Woolfolk, Anita: Psikologji edukimi, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Tiranë, 2011

Faqe të internetit

- ✓ <http://www.masht-gov.net>
- ✓ <http://www.european-agency.org>
- ✓ <http://pedagogjia.wordpress.com>
- ✓ http-www.izha.edu.al-matereiale-Revista_Pedagogjike_2011.pdf.url
- ✓ <http://pedagogjia.wordpress.com/>
- ✓ <http://www.iccog.co.me-ispitni-images-Nacionalni ispitni-2010-2011>
- ✓ <http://www.downsyndromekosova>
- ✓ <http://www.inclusive-education-in-action.org>
- ✓ http://en.wikipedia.org/wiki/Special_educatio
- ✓ <http://www.benchmarkeducation.com/old/supporting>

Shtojcë: Lista e shkollave të përfshira në hulumtim

Lista e Qendrave Burimore

Emri i qendrës burimore	Llojet e dëmtimeve	Vendi
Xheladin Deda	Dëmtime në të parë	Pejë
Nëna Terezë	Dëmtime në të dëgjuar	Prizren
Përparimi	Dëmtime intelektuale	Prishtinë
Nëna Terezë	Dëmtime intelektuale	Mitrovicë
Lef Nosi	Dëmtime intelektuale	Prizren

Lista e shkollave të rregullta – përfshirëse

Emri i shkollës	vendi
Lekë Dukagjini	Prizren
Shemsi Ahmeti	Shupkovc
Lirija	Milloshëvë
Shkëndija	Reçan
Abdulla Shabani	Mitrovicë
Ismail Qemali	Prishtinë
Ibrahim Mazreku	Malishevë
Lidhja e Prizrenit	Prizren
Naim Frashëri	Prishtinë
Emin Duraku	Prishtinë
Fazli Grajqevci	Shipol
Anton Zako Çajupi	Bardhosh

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja KGT, Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – CIP

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

376.4-056.34(048)

Reçica, Sahare

Mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta: raport hulumtimi / Sahare Reçica. – Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2013. – 82 f.: ilustro. Me ngjyra; 22 cm.

Parathënie: f. 5-8

ISBN978-9951-591-07-02